

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6843
E mërkurë, 8 mars 2023
çmimi 0.40 €

BE-ja dhe Qeveria e Kosovës ndajnë 45 bursa të reja për studime master në BE



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, ËSHTË PRITUR NË BERLIN
NGA KANCELARI I GJERMANISË OLAF SCHOLZ

PLANI FRANKO-GJERMAN, SCHOLZ: BESOJ SE KY PROCES DO TË PËRFUNDOJË SË SHPEJTI ME SUKSES



Propozimi evropian i titulluar "Marrëveshja drejt normalizimit Kosovë - Serbi" ishte një nga temat e diskutimit në takimin në mes të kancelarit të Gjermanisë, Olaf Scholz dhe kryeministrit të

Shqipërisë, Edi Rama, në Berlin. Kancelari gjerman ka theksuar se pret që ky proces të përfundojë shpejt. "Me të vërtetë kemi të bëjmë me një propozim shumë të peshuar të Gjermanisë e Francës

dhe që gjeti pasqyrimin e tij edhe në vendimet e Komisionit Evropian në Bruksel. Në këtë kuadër besoj se ky proces do të përfundojë së shpejti me sukses", ka deklaruar Scholz

NË KOSOVË FESTOHET 7 MARS, BËHET THIRRJE PËR ARSIM CILËSOR



AMBASADORI FRANCEZ: OPOZITA TA SHOHË ÇËSHTJEN E ASOCIACIONIT NGA NJË PERSPEKTIVË MË E GJERË



OPINION

PSE AQ SHUMË TRYSNI PËR NJË MARRËVESHJE TË KEQE DHE TË IMPONUAR?!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

AKTUALE



UKRAINA NIS BISEDIMET PËR ZGJATJEN E MARRËVESHJES PËR EKSPORTIN E GRURIT

BARNA QË RUHEN VEND E PA VEND BRENDA QKUK-së

EKONOMI



JOFORMALITETI CENON GRATË NË BUJQËSI

SPORT



KOSOVA SYNON FITORE NDAJ BOSNJË-HERCEGOVINËS

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Nënkryetari i Parlamentit të Hungarisë: E mbështetim anëtarësimin e Suedisë në NATO

SOFJE, 7 MARS - Një delegacion parlamentar nga Hungaria tha më 7 mars se e mbështet aplikimin e Suedisë për anëtarësim në NATO. Kështu tha nënkryetari i parlamentit hungarez, Csaba Hende, pas një takimi me kryetarin e parlamentit suedez, Andreas Norlen, në Stokholm të Suedisë. "Ne e mbështetim anëtarësimin e Suedisë në NATO", tha Hende për agjencinë suedeze të lajmeve TT.

Disa ligjvënës hungarezë kanë ngritur dyshime nëse duhet t'i

mbështetim aplikimet për anëtarësim në NATO nga Suedia dhe Finlanda, duke përmendur ato që ata i quajnë "gënjeshtër të hapura" nga Stokholmi dhe Helsinki për gjendjen e demokracisë në Hungari. Por, delegacioni hungarez tha të martën se parlamenti do ta ratifikojë përfundimisht aplikimin e Suedisë në NATO.

Më 2 mars Parlamenti i Hungarisë njoftoi se ka shtyrë ratifikimin për dy javë dhe ligjvënësit hungarezë pritet të votojnë në seancën e 20 marsit.

Hungaria mbetet i vetmi vend anëtar i NATO-s që, përveç Turqisë, nuk ka miratuar ende aplikimet e dy vendeve nordike për t'iu bashkuar aleancës ushtarake perëndimore.

NATO kërkon që të 30 shtetet t'i ratifikojnë aplikimet për anëtarësim me qëllim që të pranohen shtetet e tjera. Partia e kryeministrit hungarez Viktor Orban ka mbështetur pranimin e Finlandës dhe Suedisë në NATO. Por, opozita hungareze ka kritikuar partinë e Orbanit se po zvarrit këtë çështje.



Ukraina nis bisedimet për zgjatjen e marrëveshjes për eksportin e grurit



KIEV, 7 MARS - Kievi ka nisur bisedimet online me partnerët për zgjatjen e marrëveshjes për grurin në Detin të Zi, tha një burim i lartë i Qeverisë së Ukrainës.

Burimi tha se Ukraina nuk ka zhvilluar diskutime me Rusinë e cila bllokoi portet e Detit të Zi të Ukrainës pas pushtimit të saj vitin e kaluar, por tha se Kievi e kupton që partnerët duhet të bisedojnë edhe me Moskën.

Marrëveshja e grurit në mes të Ukrainës dhe Rusisë, e cila u arrit

me ndërmjetësimin e Kombeve të Bashkuara dhe Turqisë, do të skadojë më 18 mars nëse palët nuk bien dakord për zgjatjen e saj.

Kjo marrëveshje, e cila lejon eksportin e sigurt të grurit nga portet e Ukrainës, u arrit në muajin korrik të vitit të kaluar. Përmes saj u krijua një korridor i mbrojtur transiti detar dhe u projektua për t'i lehtësuar mungesat globale të ushqimit duke lejuar rifillimin e eksporteve nga tri porte në Ukrainë. Ukraina

është prodhuesja e shtatë më e madhe e grurit në botë dhe parashikohet të jetë eksportuesja e pestë më e madhe.

Eksportet e grurit përbëjnë burime të rëndësishme të të ardhurave për Ukrainën, sidomos pas shkatërrimit të ekonomisë së saj prej shpërthimit të luftës.

Një bllokadë eventuale në eksportet ukrainase të grurit do të ndikonte edhe në rritje të çmimeve dhe inflacionit më të lartë.

Ndalen trenat në Francë, vazhdojnë protestat kundër reformave në pensione

PARIS, 7 MARS - Shumica e trenave u ndalën, rafineritë e naftës u bllokuan dhe prodhimi i energjisë u reduktua të martën në Francë, ndërsa sindikatat organizuan ditën e gjashtë të grevave mbarëkombëtare kundër planit për reforma në pensione të presidentit Emmanuel Macron. Plani i Macronit për ta rritur moshën e pensionimit nga 62 në 64 vjeç është reforma e tij më e madhe gjatë mandatit të dytë presidencial.

Pas thirrjeve të përsëritura që

Qeveria e Francës të heqë dorë nga ky plan, sindikalistët kanë paralajmëruar përshkallëzim të situatës.

Gjithashtu, është paralajmëruar edhe mbyllja e shkollave.

Më shumë se një milion njerëz pritet të protestojnë në Paris dhe në qytetet e tjera. "Së bashku... le ta ndalim Francën!", thanë sindikatat kryesore të vendit në një deklaratë të përbashkët.

Kjo është hera e parë që nga viti 2010 që të gjitha sindikatat i bashkojnë forcat kundër një

reformë të planifikuar. Franca ka moshën më të ulët të kualifikimit për pension shtetëror në mesin e ekonomive më të mëdha evropiane.

Pensioni mesatar është 1 400 euro në muaj pasi të zbriten taksat.

Qeveria ka thënë se ndryshimet janë të nevojshme për ta garantuar të ardhmen e financimit të sistemit pensional, që pritet të kalojë në deficit në vitet e ardhshme për shkak të plakjes së popullsisë.



Kilicdaroglu, kundërkandidat i Erdoganit në zgjedhjet presidenciale turke



ANKARA, 7 MARS - Lideri i opozitës turke, Kemal Kilicdaroglu, është zgjedhur që të jetë kundërkandidati i presidentit aktual turk Rexhep Tajip Erdogan në zgjedhjet që pritet të mbahen më 14 maj.

Koalicioni opozitar, i përbërë nga gjashtë parti, e zgjodhi atë

më 6 mars si kandidat për president.

Kilicdaroglu, 74 vjeç, është kryetar i partisë së dytë më të madhe në shtet. Ai shpreson ta largojë Erdoganin nga posti i presidentit pas më shumë se dy dekadash në pushtet. "Tryeza jonë është tryezë e paqes. Qëllimi

ynë i vetëm është ta çojmë shtetin në ditë të prosperitetit, paqes dhe gëzimit", tha Kilicdaroglu, kryetar i Partisë Popullore Republikane (CHP), gjatë një fjalimi në Ankara. "Do ta qeverisim Turqinë në bazë të konsultimeve dhe konsensusit", theksoi ai.

Në Kosovë festohet 7 marsi, bëhet thirrje për arsim cilësor

PRISHTINË, 7 MARS (ER) - Mësonjëtorja e Korçës - shkolla e parë kombëtare e gjuhës shqipe në viset shqiptare e hapur më 7 mars 1887 - është një prej ngjarjeve që e ka bërë kthesën e madhe në realitetin tonë, në vazhdimësinë tonë si shqiptar, si dhe në ruajtjen e gjuhës e vlerave tona. Gjatë historisë së popullit tonë ishin mësimdhënësit ata që brumosën breza të tërë për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare. Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, mësueseve dhe mësuesve ua ka uruar 7 marsin, duke theksuar se mësueset e mësuesit tanë janë dëshmuar në kohë shumë të vështira, ndaj ata janë heronj të dijes. "136 vjet më parë në Korçë nisi punën mësonjëtorja e parë shqipe, e cila traso i rrugën e arsimit shqip gjithandej, duke luajtur rol qenësor në formimin e vetëdijes kombëtare që prej Rilindjes Kombëtare. Mësuese e mësues tanë janë dëshmuar në kohë shumë të vështira, ndaj ata janë heronj të dijes. Ata nuk janë vetëm persona që japin dituri, por edhe mentorë, udhëzues dhe burim frymëzimi. Në këtë ditë, të gjithë jemi mirënjohës për kontributin e çmuar të tyre në formësimin e të ardhmes sonë. Arsimit cilësor është bazamenti i një shteti dhe shoqërie të suksesshme! Mësuese e mësues të dashur, urime 7 marsi!", ka uruar Osmani.

Edhe kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka uruar për Ditën e Mësuesit. Ai ka thënë se 7 marsi është dita kur përkulemi me nderim dhe mirënjohje para forcës më përparimtare të shoqërisë sonë. "Mësuesit tanë, nga rilindasit e deri në ditët e sotme, nuk janë vetëm simbol i edukimit dhe arsimimit të brezave të tërë të kombit por edhe heronj e burim frymëzimi në rrugën e lirisë, dalzotës dhe vija e parë e qëndresës atdhetare përballë sfidave shekullore. Vlera e mësuesit dhe pesha e qiellit nuk maten kurrë, thuhet për pishtarët e dijes. Suksese në misionin tuaj të shenjtë dhe urime 7 marsi!", thuhet në urimin e Konjufcës.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, me rastin e 7 marsit ka takuar mësuesen e tij të parë, Igballe Haziri. Krasniqi në "Facebook" është shprehur se mësimdhënia nuk është vetëm një profesion, por një thirrje fisnike që kërkon durim, ndjeshmëri, patriotizëm dhe pasion, për t'ia përcjellë vlerat dhe virtytet më të larta gjeneratës së re. "Në këtë aspekt, kontributi i mësimdhënësve tanë në frymëzimin e brezave të ri për lirinë dhe dashurinë ndaj Atdheut, ka qenë vendimtar edhe në çlirimin e Kosovës", ka thënë Krasniqi. Edhe kryetari i LDK-së, Lumir

Abdixhiku, me rastin e 7 marsit, Ditës së Mësuesit, i ka uruar të gjithë mësimdhënësit dhe u ka shprehur mirënjohje për punën fisnike të tyre. "7 marsi është dita kur nderojmë dhe kujtojmë rolin dhe kontributin e jashtëzakonshëm të mësimdhënësve në edukimin dhe mësimin e brezave të tërë. Misioni dhe detyra e tyre fisnike për të shpërndarë dije është i shenjtë dhe ka vlerë të pazëvendësueshme. Sot, në këtë datë të veçantë, Lidhja Demokratike e Kosovës falënderon të gjithë mësimdhënësit që vepruan dhe punuan edhe në kushte të rënda të okupimit serb, ata që me guximin dhe sakrificën e tyre dëshmuar se rruga e dijes është rruga e lirisë dhe pavarësisë", është thënë në urimin e Abdixhikut.

Për Ditën e Mësuesit e ka uruar edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj. "Janë pikërisht



mësimdhënësit tanë që edhe në kohë të errëta të robërisë nuk reshtën së punuari në përhapjen e diturisë, duke u bërë udhërrëfyes për shumë gjenerata

në përpjekjet tona për liri e pavarësi. Si shoqëri, duhet ta rrisim edhe më tej ndërgjegjësimin për rolin jetik që mësimdhënësit japin çdo ditë

për arsimimin dhe zhvillimin e gjeneratave. Mirënjohje e respekt për gjithë mësimdhënësit për punën e tyre", thuhet në urimin e Haradinajt.

Mësuesja Shkëndije Jashari nderohet me çmimin "Shaban Jashari"



Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit ka organizuar manifestimin e shënimit të 7 Marsit - Ditës së Mësuesit, me ç'rast çmimin tradicional për mësuesin e dalluar e ka marrë mësuesja Shkëndije Jashari nga ShFMU "Meto Bajraktari" në Prishtinë, ndërsa mirënjohje kanë marrë edhe mësues të tjerë nga të gjitha komunat e Kosovës. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti

dhe zëvendësministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Edona Maloku-Bërdyna, të cilët kanë ndarë çmimin "Shaban Jashari", kanë folur për kontributin e mësuesve shqiptarë nga Pandeli Sotiri e deri te mësuesit e ditëve të sotme, për të cilët thanë se është e pamundur t'i falënderojmë aq sa meritojnë. Kryeministri Kurti, ndër të tjera, tha se shqiptarët sot kudo që ndodhen i nderojnë gjeneratat e

mësuesve që kanë dhënë gjakun e tyre për t'i mbajtur ndezur dritat e arsimit shqip, ndërsa vlerësoi lart kontributin e mësuesit dhe heroit kombëtar Shaban Jashari, emrin e të cilit e mban çmimi tradicional me të cilin nderohet puna dhe përkushtimi i mësimdhënësit të dalluar për performancë pozitive dhe rezultate të mira. Në emër të ministres Nagavci, zëvendësministria e Arsimit, Edona Maloku-Bërdyna, i uroi

mësimdhënësit me rastin e 7 Marsit teksa theksoi se çmimi tradicional për mësimdhënësin e dalluar është i mbështjellë me petkun e një mësimdhënësi dhe njeriu të dalluar, siç ishte Shaban Jashari. Mësimdhënësjja, e cila pranoi çmimin, Shkëndije Jashari, tha se çmimi i fituar për të është detyrë, privilegj dhe përgjegjësi për edukimin e brezave të rinj të cilët janë e ardhmja e vendit.



KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, ËSHTË PRITUR NË BERLIN NGA KANCELARI I GJERMANISË OLAF SCHOLZ

Plani franko-gjerman, Scholz: Besoj se ky proces do të përfundojë së shpejti me sukses

Propozimi evropian, i titulluar “Marrëveshja drejt normalizimit Kosovë - Serbi”, ishte një nga temat e diskutimit në takim në mes të kancelarit të Gjermanisë, Olaf Scholz dhe kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, në Berlin. Kancelari gjerman ka theksuar se pret që ky proces të përfundojë shpejt. “Me të vërtetë kemi të bëjmë me një propozim shumë të peshuar të Gjermanisë e të Francës dhe që gjeti pasqyrimin e tij edhe në vendimet e Komisionit Evropian në Bruksel. Në këtë kuadër besoj se ky proces do të përfundojë së shpejti me sukses”, ka deklaruar Scholz

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 MARS - Gjermania dëshiron t'i mirëpresë vendet e Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian sa më shpejt që të jetë e mundur, tha të martën kancelari Olaf Scholz. Shqipëria po bën përparim të mirë drejt anëtarësimit në bllok, theksoi Scholz në një konferencë të përbashkët për medie në Berlin me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. “Marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Gjermanisë dhe Shqipërisë janë të shkëlqyera”, u

tha kancelari gjerman gazetarëve, duke shtuar se qeveria e tij do të mbetet “partnere e besueshme” në përpjekjen e Tiranës për t'u bashkuar me BE-në.

Vendet e rajonit ndodhen në faza të ndryshme në procesin e zgjerimit.

Mali i Zi ka avancuar më së shumti dhe i ka hapur të gjithë kapitujt e negociatave.

Serbia pason si shtet që është në procesin e negociatave, por vitin e kaluar nuk ka hapur asnjë kapitull të ri. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut sapo i kanë nisur negociatat, ndërsa Bosnjë-Hercegovina ka

marrë mendim pozitiv nga Komisioni Evropian për dhënien e statusit të vendit kandidat.

Kosova ka aplikuar në dhjetor të vitit të kaluar për anëtarësim në BE. Deri më tani Kosova ka vetëm një marrëveshje kontraktuale me BE-në, përkatësisht Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit që u nënshkrua në Strasburg më 17 tetor të vitit 2015.

Propozimi evropian i titulluar “Marrëveshja drejt normalizimit Kosovë - Serbi” ishte një tjetër çështje diskutimi në takim Scholz - Rama.

Kancelari gjerman tha se pret që ky

proces të përfundojë shpejt. “Me të vërtetë kemi të bëjmë me një propozim shumë të peshuar të Gjermanisë e Francës dhe që gjeti pasqyrimin e tij edhe në vendimet e Komisionit Evropian në Bruksel. Në këtë kuadër besoj se ky proces do të përfundojë së shpejti me sukses”, tha Scholz.

Më 27 shkurt kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti serb, Aleksandar Vučić, e kanë pranuar këtë propozim. Marrëveshja për të cilën janë bërë përgatitje prej vjeshtës së vitit 2022 mbulon shumë aspekte në marrëdhëniet mes dy vendeve nuk është nënshkruar ende, mirëpo është publikuar zyrtarisht nga Bashkimi Evropian.

Kancelari gjerman njoftoi se samiti i ardhshëm i Procesit të Berlinit do të zhvillohet më 16 tetor në Tiranë. Kryeministri Rama tha se në këtë samit do të bëhet bilanci i arritjeve të këtij procesi. “Bashkëpunimi rajonal është e vetmja rrugë që ne kemi dhe në këtë rrugë jemi me fat se Gjermania është një

bashkudhëtare e vëmendshme dhe e përfshirë drejtpërdrejt”, tha Rama.

Më 6 dhjetor të vitit të kaluar samiti në mes të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor është mbajtur në Tiranë për herë të parë jashtë kufijve të bllokut evropian. Aty liderët e Bashkimit Evropian kanë rikonfirmuar përkushtimin e palëkundur për anëtarësimin e Ballkanit Perëndimor në bllokun evropian.

Kryeministri Rama ndodhet në Berlin në një vizitë zyrtare. Atje ai pritet të takohet edhe me përfaqësues të bizneseve gjermane për të diskutuar mbi perspektivën e Shqipërisë në kuadrin e zhvillimit turistik rajonal si dhe rolin bashkëpunues të Gjermanisë në këtë drejtim përmes investimeve në këtë sektor si dhe turistëve të saj. Rama pritet ta vizitojë edhe Panairin Ndërkombëtar të Turizmit, i cili çdo vit mirëpret rreth 10 000 ekspozues nga më shumë se 180 vende, mes të cilave do të jetë edhe stenda shqiptare.

Ambasadori francez: Opozita ta shohë çështjen e Asociacionit nga një perspektivë më e gjerë

PRISHTINË, 7 MARS - Ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guerot, ka thënë të martën se marrëveshja e diskutuar për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë në takim në Bruksel do të mund të ishte një moment historik për të dyja vendet.

Në një prononcim për medie, Guerot ka thënë se kjo marrëveshje është pozitive dhe në interesin e Kosovës.

“Mendoj se jemi në një moment premtues. Ka mundësi reale të bëjmë progres konkret në rrugën e normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Marrëveshja që u diskutua më 27 shkurt ka potencial për të dyja vendet, për Kosovën dhe Serbinë. Është diçka shumë pozitive dhe në interesin e Kosovës si shtet”, u shpreh ai para gazetarëve.

Guerot foli edhe për qëndrimet



e opozitës, për të cilët tha se duhet ta shikojnë çështjen e Asociacionit nga një perspektivë më e gjerë. “Kosova

është një vend demokratik dhe është normale që pozita dhe opozita të jenë në kundërshtim për çështje të ndryshme. Ne siç

kemi kërkuar nga Qeveria e Kosovës, kërkojmë njëjtë edhe nga opozita që ta shohin çështjen e Asociacionit nga një perspektivë më e gjerë, ta shohin ‘pikturën e madhe’ dhe t’i vlerësojnë përpjekjet që komuniteti ndërkombëtar po bën për Kosovën dhe Serbinë”, ka thënë ambasadori francez.

Guerot ka pohuar se shpreson që marrëveshja në mes të Kosovës dhe Serbisë të finalizohet më 18 mars, kur do të jetë edhe takimi i radhës.

NATO-ja: Rast historik për paqe të qëndrueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë

BRUKSEL, 7 MARS - Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se mirëpret qasjen konstruktive nga Kosova dhe Serbia në dialogun që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian dhe theksoi se tani është një "rast historik" për të arritur paqe të qëndrueshme. Këto deklarata ai i bëri pas takimit në Bruksel me presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj, i cili, po ashtu, shprehu mbështetjen për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e raporteve. "Ne bashkëpunojmë me Bashkimin Evropian dhe mirëpresim takimet në Bruksel në kuadër të dialogut. NATO do të vazhdojë ta mbështesë fuqishëm këtë dialog sepse e shohim si rrugën e vetme të duhur për paqe dhe stabilitet në Kosovë. Kemi një

rast historik për paqe të qëndrueshme dhe mirëpres qasjen konstruktive. Është me rëndësi që të dyja palët të dëshmojnë fleksibilitet dhe gatishmëri për kompromis. Secila zgjidhje duhet të ketë parasysh të drejtat e njeriut, fqinjësisë së mirë dhe sundimit të ligjit", tha shefi i NATO-s.

Deklaratat e Stoltenbergut vijnë pasi Kosova dhe Serbia më 27 shkurt pranuan propozimin evropian për normalizimin e raporteve. BE-ja tha se në takimin në Bruksel, kryeministri Albin Kurti dhe presidenti serb Aleksandar Vuçiq, u pajtuan që nuk ka nevojë për diskutime të mëtejme për këtë propozim, që palëve u është dorëzuar vitin e kaluar.

Blloku evropian më pas tha se

palët kanë shprehur gatishmërinë që të punojnë në planin për zbatimin e propozimit evropian, që synon t'i çojë palët drejt një marrëveshjeje përfundimtare gjithëpërfshirëse për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Stoltenbergu, po ashtu, përsëriti gatishmërinë e aleancës ushtarake perëndimore që të sigurojë paqe dhe stabilitet në Kosovë dhe më gjerë në rajon. "NATO ka qenë në Kosovë për shumë vjet. Prania e KFOR-it [misioni i NATO-s në Kosovë] ka luajtur dhe vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në promovimin e paqes dhe sigurisë së lëvizjes për të gjithë në Kosovë. Aleatët janë të gatshëm të vazhdojnë këtë. Një prani substanciale e NATO-s është

dëshmuar e duhur për sigurinë", tha shefi i aleancës ushtarake perëndimore.

Ndërkaq presidenti shqiptar Bajram Begaj foli për rreziqet e sigurisë me të cilat përballet rajoni i Ballkanit Perëndimor, duke tërhequr vërejtjen nga rreziku që vjen nga ndikimi i Rusisë. "Rajoni i Ballkanit vijon të kërcënohet nga përpjekjet e ndërhyrjes së Rusisë. Rusia po rrezikon rajonin dhe interesat e NATO-s. Qëllimi i Rusisë është bllokimi i proceseve demokratike në rajon. Kemi ndjekur me shqetësim zhvillimet në veri të Kosovës. Vlerësojmë maksimalisht angazhimin e NATO-s në rajon. KFOR-i është garantues i paqes në Kosovë dhe rajon. Po kalojmë një kohë kur nevojiten vendime të guximshme.

Dhe është koha që të shqyrtohet anëtarësimi i Kosovës në strukturat euroatlantike", tha Begaj. Ai tha se anëtarësimi eventual i Kosovës në NATO do të përbënte "një vlerë të shtuar për aleancën".

Rreth 50 000 forca të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, u vendosën në Kosovë pas përfundimit të luftës më 1999 me synim që të garantojnë sigurinë. Aktualisht në vend janë afër 4 000, një numër i konsiderueshëm i të cilëve vijnë nga vendet që nuk janë anëtare të NATO-s.

Kosova në fundin e vitit të kaluar dorëzoi aplikimin për anëtarësim në BE, teksa shteti, po ashtu, aspiron të bëhet pjesë fillimisht e Partneritetit për Paqe të aleancës dhe eventualisht të bëhet edhe anëtar i NATO-s.



Lajçaku të enjten nis turneun në Kosovë dhe Serbi për përgatitje të takimit të Ohrit

PRISHTINË, 7 MARS - I dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, të enjten dhe të premten do të qëndrojë në Prishtinë për takime me liderë të institucioneve të Kosovës, por edhe me përfaqësues të opozitës. Në fillim të javës së ardhshme ai do të qëndrojë dy ditë edhe në Beograd.

Vizitat i ka konfirmuar Peter Stano, zëdhënës i BE-së për çështje të jashtme dhe siguri. Sipas Stanos, Lajçaku në Prishtinë do të qëndrojë më 9 dhe 10 mars, ndërsa me 13 dhe 14 do të qëndrojë në Beograd. Ai ka thënë se pas takimit që liderët

e Kosovës dhe Serbisë, Albin Kurti dhe Aleksandar Vuçiq, kanë pasur së fundi në Bruksel më 27 shkurt, Lajçaku do të shkojë në Prishtinë dhe Beograd për t'i vazhduar ato diskutime dhe për ta përgatitur takimin e radhës më 18 mars në Ohër.

Stano ka konfirmuar se tash qëllimi kryesor është të arrihet pajtimi rreth një plani si dhe modaliteteve për zbatimin e marrëveshjes. Ai ka thënë se qëllimi final është normalizimi gjithëpërfshirës i raporteve përmes një marrëveshjeje ligjërish obliguese, por kjo, sipas tij, do të pasojë në fund të procesit.

Zëdhënësi i BE-së ka përsëritur se në takimin e mbajtur së fundi, Kurti dhe Vuçiqi ishin pajtuar për tekstin e marrëveshjes, e kishin miratuar atë, por nënshkrimi i saj nuk ishte i paraparë për atë takim.

Bashkimi Evropian, siç ka thënë para disa ditësh edhe një zyrtar i lartë i tij, synon që, në një skenar ideal, në takimin e radhës ndërmjet kryeministrit Kurti dhe presidentit Vuçiq për të cilin është konfirmuar se do të zhvillohet në Ohër më 18 mars, të arrihet pajtimi edhe për planin e zbatimit të marrëveshjes për normalizimin e raporteve.



Pse aq shumë trysni për një marrëveshje të keqe dhe të imponuar?!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Trysnia dhe shantazhi gjithmonë iu dhezë ndërkombëtarëve: Së fundi, pas bisedimeve të fshehta e që nga Kosova udhëhiqeshin nga një person pa përvojë në bisedime, pa shtyllë kurrizore, pa të kaluar kombëtare dhe politike në rrethana të një errësire informative me të zezë se në Ferrin e Dantes, propozuesit e këtij komploti franko-gjerman dolën me një draftpropozim që, më herët nga Besnik Muçiverca ishte vlerësuar të jetë në linjë të plotë me interesat e Serbisë. Në të njëjtën kohë, Gazda i Besnikut jo një herë deklaronte se ky propozim është i mirë dhe se siguron njohjen de fakto nga Serbia për Kosovën, ndërkaq që njohja de jure, për shkak të humbjes së peshës juridike dhe diplomatike, është hequr nga përdorimi. Fillimisht edhe nga amerikanët njohja reciproke në qendër ishte alfa dhe omega e çdo marrëveshje për normalizim, ndërsa “ndërmjetësuesit” evropianë, mashtruesi Lajçak dhe Rrahman Morina i Katalonjës, Joseph Borrell, e përdorin këtë formulim sa për sy e për faqe, për ta shuar kundërshtimin shumë të qullët, kryesisht në Prishtinë, e sapo shkonin në Beograd, në ndikimin e shlivovices serbe dhe ritmin e Zhikino Kollos (Vallja e Zhikës), i mëshonin pikës së parë; formimit të Zajebnicës, Republikën e Kishës Ortodokse Serbe brenda Kosovës, me kryeqytet Manastirin e Deçanit dhe kryetar Otac Sava Janjiq, që, nëse do të bëheshin hetime serioze, vështirë se do të shpëtonte nga përgjegjësia për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Po, jam i sigurt, shihe ti, jam i sigurt se në padinë për gjenocid në Ruandë që do ta përgatisë Qeveria e Kosovës, Otac Sava do të jetë yll. Ky propozim franko-gjerman është hartuar duke marrë për bazë propozimin midis dy gjermanive e që pastaj u bë vetëm një Gjermani. Edhe në këtë propozim kushtëzues dhe të keq që nuk e zgjidh asnjë problem, por e konservon për një afat të pacaktuar, paqja dhe normalizimi janë të përkohshëm. Prandaj është propozim i keq,

bullshit propozim, shajzen propozim sepse, në vend se përfundimisht ta ndajë Kosovën nga Serbia, pas një kohe krijon kushte për forcim të këtyre lidhjeve duke e faktorizuar Serbinë aq shumë sa që e bën bashkëpronare të integritetit territorial të Kosovës sikur që, gjithashtu, e bën bartëse të sovranitetit, së paku në territoret që do të administrohen nga Zajebnica, me çfarëdo emri qoftë sikur edhe pengues i thuaja në të gjitha proceset që kanë rëndësi të madhe për Kosovën. Përralla janë se Serbia me këtë marrëveshje de fakto e njeh Kosovën, se marrëveshja është ndërtuar sipas një arkitekture të dy shteteve të pavarura, se do ta njohin pesë shtetet mosnjohëse, se do të bëhemi anëtar i Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, BE-së, Interpolitit dhe të tjera. Po e shihni se edhe kërkesa për anëtarësim në Këshill të Evropës po përdoret si shantazh dhe kushtëzim që Kosova ta pranojë këtë propozim sikur që ishte përdorur kushtëzimi e që ende po përdoret në procesin e liberalizimit të vizave. Në kohën kur Sholci i bën trysni jonormale Albin Kurtit të pranojë këtë propozim, me Zajebnicën në qendër, po i njëjti Sholc e hap një fabrikë gjermane në Novi Sad, Vojvodinë, ku ka investuar mbi 140 milionë euro dhe ku do të punësohen 5 000 punëtorë. Çka investoi dhe hapi Gjermania në Kosovë, sa vende pune i siguroi (në Serbi 85 000 vende pune janë siguruar nga investimet gjermane). Albin Kurti, në përpjekje të mos e pranojë Ballkanin e Hapur dhe me verdisje për Procesin e Berlinit, iu dorëzua Sholcit pa asnjë kusht duke bërë përpjekje ta rivalizojë Amerikën përmes përcaktimit për Sholcin. Nëse flasim drejt, as ish-kancelarja gjermane Anxhela Merkel në planin e investimeve nuk ka bërë asgjë për Kosovën, kurse shumë për Serbinë. Ndërkombëtarët e duan lirin e rezistencës më të vogël, kurse Kosovën e duan shumë sepse këtu nuk hasin fare në rezistencë, nuk kanë nevojë të bëjnë planin a, b, c, d, e etj. për Kosovën sikur që e bëjnë

për Serbinë. Albin Kurti doli para medieve dhe tha se ai ishte në gjendje menjëherë ta nënshkruajë marrëveshjen, porse Vuçiçi qenka pengesa, nuk pranoi ta nënshkruajë këtë marrëveshje. Oralisht, sipas ndërkombëtarëve, edhe Kurti edhe Vuçiçi janë në rregull, e kanë dhënë pëlqimin për këtë propozim. Ky propozim franko-gjerman fillimisht konsiderohej si propozim i këtyre dy shteteve, pastaj doli si propozim evropian që përkrahej nga amerikanët e që tani e ka vulën e të gjithë atyre që vrasin e kthjellin në botë. Evropianët duke e ditur se Kosova nuk e refuzon asnjë propozim, me mjeshtëri dhe poshtërsi e hoqën si kusht njohjen reciproke në qendër të marrëveshjes. Serbia u nda fituese absolute, Kosova me brekë të lëshuara, me mundësi ta mbulojë prapancën me gjethe të fikut. Sa të poshtër janë!

Po kush nuk po e kundërshton aktgjykimin franko-gjerman: Në Kosovë është në rritje fryma jugosllave dhe serbe përmes ish-bashkëpunëtorëve të tyre dhe zgjatjeve biologjike që i kanë zënë vendet kyçe të pushtetit, tash të shndërruar në mercenarë politikë. Është një frymë e fuqishme e përpjekjeve për ndryshim të historisë ku UÇK-ja përdoret vetëm për një përdorim dhe një qëllim, për marrje dhe mbajtje të pushtetit, me një dëshirë dhe me një qëllim! Kemi një të ashtuquajtur Grup Teknik që i jep këshilla kurbanit të Albin Kurtit, Besnik Muçivercës e që paguhen, nuk e besoj më pak se 3 500 euro në muaj. Për çka? Për dëmet që ia bëjnë Kosovës. Thënë të drejtën, 2 të 3 e këtij grupi janë emocionalisht të lidhur me ish-Jugosllavinë, paraardhësit e të cilëve kanë lënë kokë e këmbë për Jugosllavinë, ndërsa këta janë zëvendësues origjinalë të tyre; kanë marrë pjesë thuaja në të gjitha proceset pas përfundimit të luftës në Kosovë. Tash nuk shohin asgjë të keqe në këtë propozim. Në këtë grup ka anëtarë, paraardhësit e të cilëve kanë qenë denoncues

kundër Bacës Adem Demaçi dhe patriotëve të tjerë e që sot, me bekimin e kryeministrit Kurti, po identifikohen si “shpëtimtarë të Kosovës”. Albin Kurti është mirënjohës për këtë; me të dëgjuar që një nga ta ka nevojë për mjete shtesë financiare, ia punëson të bijën si këshilltare. Po dëgjoj se militantët e Kurtit po hulumtojnë nëse dikush nga pasardhësit e Rrahman Morinës, Ali Shukrisë, Sinan Hasanit, Mehmet Maliqit, Gazmend Maliqit - kriminel i UDB-së, Kolë Shirokës e patriotëve të tjerë të shquar jugosllavë dhe serbë ka nevojë për një vend pune, t’i rehatojnë si respekt dhe kujtim për veprat e tyre të mëdha patriotike; ndjekjen, rrahjen, arrestimin, dënimin dhe vrasjen e atyre që tërë jetën u angazhuan për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar. Sa të poshtër, kush do ta besonte këtë! Kryeministri Kurti është deklaruar se ky propozim është i mirë, por se ky nuk ka kontribuar me asgjë për përmbytjen e tij, por se kjo është rezultat i bisedimeve dhe atyre që ishin në krye të bisedimeve, Besnik Muçiverca nga Kosova. Kjo qartazi nënkupton se në çastin kur do ta rrahë pyka pykën dhe se do të adresohet përgjegjësi, për çdo vednim të mundshëm të dëmshëm, e do të ketë shumë vendime të dëmshme, Albin Kurti, si Pont Pilati do t’i lajë duart nga çdo përgjegjësi për ta kryqëzuar si përgjegjës pikërisht Besnik Bislimin, për mua është i pafajshëm për faktin se është krejtësisht i padijshëm për punën që e bën. Mëkati i tij është se po gënjën, po mashtron, nuk po flet kur duhet dhe si duhet, krejt në përpjekje ta mbulojë dhe arsyetojë Gazdën prandaj edhe do të kryqëzohet, gozhdën e fundit prej therës së murrizit do t’i ngulë pikërisht punëdhënësi i tij, kryeministri Kurti! Në “kortezhin e përmortshëm” nuk do të marrin pjesë as Lajçaku e as Borrelli e lëre më Eskobari. Do të jemi ne që e kritikojmë, por që kemi shpirt dhe na vjen keq për Robin e Zotit! AAK-ja është edhe më e bindur se vetë Albin Kurti se kjo marrëveshje është

jo e mirë, por e shkëlqyeshme dhe duhet pranuar pa e lexuar fare. Largpamës janë këta! E keqja është se te ndërkombëtarët pesha specifike politike e AAK-së është e papërfillshme dhe se nuk e marrin seriozisht. Ndërkombëtarët nuk do të lejojnë që kjo marrëveshje të pranohet vetëm nga LV-ja dhe jashtë kësaj të mbesin PDK-ja dhe LDK-ja. Ata i duan brenda në kanalizimin politik ku po noton aneksi i marrëveshjes dhe, pa pëlqimin e tyre, nuk ka marrëveshje. Albin Kurti e ka të qartë se, në fund të fundit, edhe PDK-ja si dhe LDK-ja do të detyrohen t’i bëhen krahë, prandaj edhe sillet ashtu si po sillet. Po të ishte një opozitë e vendosur e që nuk e ka hipotekë Zajebnicën që vetë e kanë nënshkruar, do të këndohej një këngë tjetër. Se “bindja” ndaj propozimit do të pranohet edhe nga PDK-ja dhe LDK-ja është formula e kafes amerikane, në fillim ta dërgojnë një porosi publike sikur që e bënë mbrëmë pastaj, nëse ka rezistencë e shprehur në mikronë, të thërrasin për kafe të mëngjesit në Ambasatën Amerikane që i ka muret rrethuese më të larta se Burgu për Siguri të Lartë në Gërdoc. Po e shihni se Lumir Abdixhiku u ftua në Paris nga zonja Makron, sigurisht jo për festën e 8 Marsit. Nuk kam asnjë dyshim se edhe PDK-ja sikur edhe LDK-ja do të rreshohen prapa aleatëve propozues të planit famëkeq franko-gjerman. Me krosime nga e djathta (LDK-ja) dhe nga e majta (PDK-ja) me qendërsulmues Albin Kurtin, mund të pritet rreth golash në portën e pambrojtur të Kosovës. Marrëveshja e propozuar, me aneksin ende sekret, pa asnjë dyshim hap shumë perspektiva për Kosovën që... në të ardhmen t’i forcojë shumë lidhjet me Serbinë, si federatë apo konfederatë. Pa asnjë dyshim se do të diskutohet edhe për statusin e Kosovës. Pse, a nuk është edhe tani në diskutim?! Uroj ta huq krejtësisht parashikimin. Nëse unë gaboj, humbja është personale, nuk ka pasoja. Nëse ndodh e kundërta, do të bëhet keq. Dhe do të bëhet keq!

Barna që ruhen vend e pa vend brenda QKUK-së

PRISHTINË, 7 MARS - Për t'i shmangur rreziqet e mundshme nga përdorimi, barnat duhet të ruhen në kushte të përshtatshme të temperaturës, lagështisë dhe dritës, por kjo nuk ndodh gjithëherë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). "Radio Evropa e Lirë", gjatë një vizite në Klinikën e Pediatriisë më 22 shkurt, ka parë barna që përdoren për trajtimin e fibrozës cistike, të vendosura vend e pa vend në një kabinet për kryerjen e analizave.

Barna të tilla ka pasur në dysheme, në një pjesë të një dollapi dhe në një frigorifer të vogël ushqimesh. Ushtruesja e detyrës e drejtoreshës së Shërbimit Klinik Farmaceutik të Kosovës, Shqipe Fetahu, e cila shoqëroi ekipin e REL-it, tha se produktet mjekësore në QKUK, në përgjithësi, ruhen në përputhje të standardeve. Por, sipas saj, përmirësimet janë të nevojshme në disa reparte - përfshirë kabinetin ku jepen barnat për fibrozë cistike - një sëmundje gjenetike që prek kryesisht sistemin e frymëmarrjes dhe atë të tretjes. "Fillimisht duhet të shtohet inventari apo raftet për ruajtjen e produkteve që ruhen në temperaturë të dhomës. Pastaj është i nevojshëm një frigorifer mjekësor, gjithashtu edhe termohigrometri që e monitoron temperaturën dhe lagështinë", tha Fetahu.

Ambientet e repartit ku ndodhet

kabineti për trajtimin e fibrozës cistike ngrohen përmes sistemit qendror të ngrohjes. Për kontrollimin e nivelit të ngrohjes nuk ka mekanizëm rregullues të temperaturës.

Sipas statistikave zyrtare, në Kosovë janë rreth 120 pacientë të diagnostikuar me fibrozë cistike. Barnat për këtë sëmundje ata duhet t'i përdorin gjatë gjithë jetës. Këto barna ka kohë që janë përfshirë në listën esenciale, por shpërndarja e tyre në QKUK ka nisur në nëntor të vitit të kaluar. Deri atëherë pacientët i kanë siguruar vetë, herë jashtë Kosovës, herë përmes donacioneve.

Lindita Leti, e cila ka një fëmijë të diagnostikuar me fibrozë cistike, thotë se është e kënaqur me shërbimet në Pediatri, por për çështjen e ruajtjes së barnave thotë se duhet të ketë më shumë kujdes.

"Jam befasuar kur kam shkuar dhe i kam parë herën e fundit krejt Creonat [lloj barnash] në tokë. Pulmozymen e kam parë që ma kanë dhënë prej frigoriferit. Kushtet nuk janë ashtu siç duhet të jenë. Kjo nuk është në rregull. Por, nuk mund të ndërhyjmë në punët e klinikës apo repartit", thotë Leti për "Radion Evropa e Lirë".

Drejtoresha e Klinikës së Pediatriisë, Violeta Grajçevci, këmbëngul se barnat që u jepen pacientëve me fibrozë cistike janë të ruajtura në mënyrën e duhur. "Për ato barna kemi bërë kërkesë



për frigorifer mjekësor, për të qenë në kushte më optimale, edhe pse edhe tash janë në kushte optimale", thotë Grajçevci për "Radion Evropa e Lirë". REL ka bërë përpjekje të bisedojë me infermierë që bëjnë shpërndarjen e këtyre barnave, por pa sukses.

Në Kosovë ekziston Shoqata për Personat e Prekur me Fibrozë Cistike. Udhëheqësi i saj, Ismet Jahiri, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se shpërndarja e barnave për këtë sëmundje ka nisur në fund të vitit 2022. Deri atëherë, sipas tij, një

pacienti i janë dashur deri në 1 500 euro në muaj për këto barna. "Barnat që ofrohen për pacientë [në QKUK] na jepen nga paketat që janë të vendosura në dysheme, ndërsa ato më të ndjeshmet i marrim nga frigoriferi", thotë Jahiri për "Radion Evropa e Lirë".

Sipas profesionistëve shëndetësorë, nëse barnat nuk ruhen siç duhet, ato mund të bëhen më pak efektive, ose në disa raste edhe toksike.

Familjarë të pacientëve me fibrozë cistike janë të shqetësuar edhe për mungesën e një repartit të veçantë

për ta. Tash për tash këta pacientë shtrohen në dhoma ku gjenden edhe pacientë me sëmundje të tjera. "Jemi duke pritur që disa muaj që të hapet repartit i fibrozës cistike dhe nuk po hapet", thotë Atdhe Rama, i cili, po ashtu, ka një fëmijë të diagnostikuar me fibrozë cistike.

Drejtoresha e Klinikës së Pediatriisë, Violeta Grajçevci, konfirmon për REL-in se janë bërë të gjitha planet për hapjen e repartit për fibrozë cistike, por nuk specifikon se kur do të mund të hapet.

BE-ja dhe Qeveria e Kosovës ndajnë 45 bursa të reja për studime master në BE

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 MARS - 45 bursa të reja u ndanë të martën në Prishtinë nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Kosovës për studime master në BE për nëpunës civilë aktualë dhe të ardhshëm nga Kosova.

Ky është raundi i 13-të i bursave të dhëna në kuadër të programit të përbashkët Young Cell Scheme (YCS), synimi i të cilit është përmirësimi i punës së administratës publike dhe shërbimeve që ajo ofron për të gjithë qytetarët që jetojnë në Kosovë. "Arsimi është me rëndësi kyçe për avancimin e zhvillimit të Kosovës në të gjitha sferat e jetës, përfshirë rrugën e saj të integritimit në BE. Jam i lumtur të shoh që numri i të rinjve që përfitojnë nga programi ynë i bursave master po rritet vit pas viti dhe se duke punuar si nëpunës civilë po sjellin ndryshim pozitiv në mënyrën se si funksionon administrata publike e Kosovës", ka theksuar ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog. Ai ka shtuar se BE-ja do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në zhvillimin e një administrate publike më profesionale, transparente dhe llogaridhënëse si përmes këtij programi të bursave,

po ashtu edhe përmes ndihmës së vazhdueshme për reformën e administratës publike.

Mbështetja e BE-së për arsimimin e nëpunësve civilë në nivel master në Kosovë ka filluar në vitin 2004. Që atëherë, në 12 raundet e mëparshme të bursave, 364 nëpunës civilë janë arsimuar në fushat që janë konsideruar më të nevojshmet nga qeveria.

Kontributi i përgjithshëm i BE-së në programin Young Cell Scheme do të arrijë në 15.3 milionë euro duke përfshirë raundin e 13, të 14-t dhe të 15-të të bursave që do të përfundojnë deri në vitin 2026. Prej tij duhet të përfitojnë gjithsej 470 të reja e të rinj.

Qeveria e Kosovës filloi bashkëfinancimin e programit në vitin 2011 dhe po mbështet raundet 12 deri në 15 me 2.5 milionë euro. "Qeveria e Kosovës e ka kuptuar detyrën e saj për të investuar në profesionalizimin e administratës sonë publike dhe ofrimin e mjeteve të nevojshme që ato t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efektive", ka thënë zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Bardhyl Dobra, duke shtuar se ky program është i rëndësishëm në kuptimin që ndikimi i tij ndikon në shumë aspekte të zhvillimit personal dhe



social. "Një administratë publike profesionale promovon transparencën dhe llogaridhënie në qeveri. Siguron që politikat dhe programet janë në përputhje me nevojat e qytetarëve", ka thënë

Dobra.

Programi i BE-së për Bursa për Studime Master i obligon përfituesit e tij që të punojnë në një nga institucionet e Kosovës për të paktën tri vjet pas diplomimit. Tri

raundet e ardhshme të programit do të zbatohen nga Universiteti Aristoteles i Selanikut në Greqi dhe Instituti Kombëtar i Shërbimit Publik në Francë në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë e Kosovës.

Joformaliteti cenon gratë në bujqësi



PRISHTINË, 7 MARS- Përqindja e grave në Kosovë që punojnë në bujqësi dhe agrobiznes është afërsisht sa e burrave, por rezultatet e punës së tyre janë pak të evidentuara, sepse punësimi i tyre në këtë fushë nuk formalizohet.

Havushe Bunjaku, e cila udhëheq biznesin "Agro medicine" në Prishtinë, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se janë vetë gratë ato që, në shumicën e rasteve, nuk pranojnë t'i deklarojnë tatimet. "Bujqësia është punë sezonale, nuk është punë e rregullt. Ato gra... familjet e tyre janë nën asistencë sociale dhe nga frika se u ndërpritet asistencë sociale, hezitojnë ta formalizojnë punën që e kryejnë për një kohë të caktuar", thotë Bunjaku, biznesi i së cilës merret me grumbullimin, përpunimin dhe shpërndarjen e bimëve mjekësore aromatike.

"Gratë janë gjysma e fuqisë punëtore në bujqësi"

Makbule Hyseni nga organizata "EcoKosWomen", e cila është pjesë e Rrjetit të Grave të Kosovës, thotë se, bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), rreth 62 për qind e popullsisë së Kosovës jeton në zona rurale. Sipas saj, popullsia në këto zona merret me punë bujqësore në mënyrë

të përhershme ose të pjesshme. Në këtë kontekst, shton ajo, angazhimi në bujqësi i grave është shumë më i madh sesa që e paraqesin statistikisht.

Të dhënat e ASK-së për vitin 2020, që kanë dalë nga Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore, tregojnë se 270 181 persona janë të angazhuar në bujqësi. Ky numër përbën 15.5 për qind të popullsisë së përgjithshme të Kosovës. "Nga ky numër, gratë përbëjnë 49 për qind të fuqisë punëtore në bujqësi, ndërsa 51 për qind janë burra. Afërsisht, 5.5 për qind e burrave janë të punësuar - flasim në aspektin e formalitetit, me kontrata. Ndërkaq, 4.6 për qind [e grave] janë të legalizuara ose të normalizuara si punëtore të angazhuara në bujqësi", thotë Hyseni për "Radion Evropa e Lirë".

Nga formalizimi të përfitimi i subvencioneve

Formalizimi i punës në bujqësi u hap grave shtigje që mundësojnë subvencionime nga ana e shtetit për projekte të caktuara, thotë Emine Kelmendi, drejtuese e Njesisë për të Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtje nga Diskriminimi në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Kosovë. "Nëse iu referohemi të dhënave për subvencione, për

vitin që shkoi [2022], gra përfituese kanë qenë 5 për qind apo gjithsej 1 325 gra fermere. Nuk jemi të kënaqur. Megjithatë jemi të kënaqur për shkak se kjo përqindje ka dalë prej numrit të grave që kanë konkurruar. Ndërkaq, te grantet, për periudhën e kaluar, të dhënat e fundit na tregojnë se kemi mbi 50 projekte për të cilat kanë aplikuar gratë dhe kanë përfituar", thotë Kelmendi për "Radion Evropa e Lirë". Sipas saj, numri i grave që do të përfitonin nga subvencionet për punën e tyre në bujqësi do të ishte shumë më i lartë në rast se ato do ta kishin të rregulluar çështjen e trashëgimisë së pronës. Pronësia ose bashkëpronësia e tokës është ndër kriteret për subvencionim dhe marrje të granteve për bujqësi. Shumica e tokave bujqësore në Kosovë janë në pronësi të burrave.

Barriera nga mospasja e pronës

Makbule Hyseni nga organizata "EcoKosWomen" thotë se mospasja e tokës së trashëguar në pronësi ose në bashkëpronësi nga ana e grave është ndër arsyet që punësimi i tyre në bujqësi - në shumë raste - mbetet joformal. Kjo, sipas saj, u shkakton probleme edhe grave që i kanë bizneset e legalizuara. "Vajzës nuk i ndahet

trashëgimia ose toka, pastaj edhe në martesë nuk i është dhënë ndonjë tokë në emër të saj. Kjo paraqet problem shumë të madh, sidomos për gruan në bujqësi - bujqësia zhvillohet në tokë - por edhe për bizneset e grave. Nëse dëshiron të qaset në financa - që është problemi më i madh i grave, për shkak se nuk kanë ndonjë burim të të ardhurave për ta zhvilluar [biznesin] - atëherë qasja në fonde të ndryshme, kredi, projekte të ndryshme, [bëhet problematike] për shkak të mospasjes së pronësisë së tokës, në emër të tyre", thotë Hyseni.

Havushe Bunjaku thotë se mungesa e tokës nën pronësinë e saj ose të përbashkët me bashkëshortin është ndër pengesat kryesore për zhvillimin e biznesit. Ajo thotë se toka të cilën e shfrytëzon për punën e saj e ka marrë me qira, por se nuk është e noterizuar për shkak se pronari nuk ka pranuar një gjë të tillë. "Unë nuk kam tokë, e gjitha është në emër të burrit. Unë as nuk kam trashëguar dhe as nuk kam tokë tash. Te Ministria e Bujqësisë unë asnjëherë nuk mund të marr grant, sepse ne e kemi vetëm një shtëpi. Do të thotë, nuk kemi tokë të mjaftueshme për të aplikuar për të marrë qoftë subvencione, qoftë grante që zhvillohen me partneritet. Besoj se gjërat do të shkonin

ndryshe [po të kisha tokë në pronësinë time]. Ndoshta do të kisha ndërtuar një fabrikë më moderne, do të përfitoja grante dhe do ta rrisja biznesin më shumë", thotë Bunjaku.

Emine Kelmendi nga Ministria e Bujqësisë thotë se ky institucion po bën përpjekje për të krijuar politika që kriteret për mbështetje financiare për qytetarët e punësuar në bujqësi, në veçanti për gratë, të jenë më afirmative dhe më lehtë të zbatueshme.

Çështja e pronësisë, sipas saj, mbetet një problem, me të cilin duhet të merren jo vetëm institucionet, por e tërë shoqëria. "Te çështja e pronës duhet të punojmë bashkë. Duke e ditur se është e shenjtë prona, fillimisht në familje, mes gruas dhe bashkëshortit duhet të nisë ajo faza e mirëkuptimit, që fuqizimi të bëhet në mënyrë të barabartë", thotë Kelmendi. Sipas të dhënave të organizatës "EcoKosWomen", vetëm rreth 17 për qind e pronave të paluajtshme në Kosovë janë të regjistruara në emër të grave. Por, aktualisht, nuk ka ndonjë të dhënë që specifikon se sa është numri i pronave mbi tokat bujqësore në emër të grave.

Sipas zyrtarëve të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 1 325 gratë fermere që kanë përfituar subvencione gjatë vitit 2022 janë bashkëpronare të tokave bujqësore.

I pathyeshëm

Kushtuar Mehmet Hajrizit, në ditën e shenjtë të mësuesit, në 15-vjetorin e pavarësisë së Kosovës dhe në 75-vjetorin e lindjes.

Nga Margarita SYZIU

Më ka emocionuar pa masë një poezi e brishtë, e ndjerë, e shkruar me lot në sy e dhimbje në shpirt, nga një vajzë shumë e vogël në atë kohë (Kimete Krasniqi) kur bishat milicore hynë në klasë dhe e arrestuan përpara nxënësve, mësuesin e tyre aq të dashur, Mehmet Hajrizin.

...

Aty mbi tavolinë
Të mbeti ditari
E ne të trishtuar
Filluam së qari

...

Dëshiroja ta theksoja këtë ndodhi, sepse Mehmet Hajrizi para së gjithash ka qenë mësues. Mësues i gjuhës shqipe. Mësues në kuptimin më të gjerë e më të bukur të kësaj fjale, ashtu siç kanë qenë dhjetëra e qindra mësues në mbarë Kosovën, që bënë sakrificat të pabesueshme, për të ruajtur gjuhën shqipe, shkollën shqipe dhe identitetin kombëtar. Sot, në këtë ditë feste, nderimi ynë shkon për të gjithë ata.

Por unë doja ta nisja këtë shkrim me fjalët përmblylëse të intervistës që Adnan Merovci bëri në muajin shkurt të këtij viti me Mehmet Hajrizin:

– Shikues të nderuar, ky është Mehmet Hajrizi; I saktë, i shkurtër, fjalëpakë, por punë shumë. Një njeri i devotshëm i çështjes kombëtare. Ju, gjeneratat e reja, mos e harroni këtë emër: Mehmet Hajrizi.

Këtij mesazhi kaq të bukur, unë do t'i mësoja edhe më shumë. Jo vetëm gjeneratat e reja duhet të mos e harrojnë këtë emër. Por edhe ata që e njohin mirë veprimtarinë e tij për çështjen kombëtare, dënimet e tij nga regjimi serb, arrestimin përpara nxënësve dhe burgun e gjatë. Edhe ata që i njohin mirë sakrificat e bashkëveprimtarës dhe bashkëvuajtësës, shoqes së jetës dhe të idealit, Haxhere Hajrizit, por edhe sakrificën e gjithë familjes, dhimbjet dhe mungesat e fëmijëve që u rritën pa babanë. E të tjera e të tjera.

Mehmeti e kishte ndjerë shumë herët peshën e madhe të pushtimit. E kishte provuar në familjen e tij, tek njerëzit e tij më të shtrenjtë. Sidomos kur i arrestuan vëllain e madh Zeqirin. E arrestuan se bashku me djalin e axhës Zenel Hajrizin dhe dajën, Banush Ademin. I dënuan me burgim të rëndë në Goli Otokun, i njohur si një nga burgjet më të tmerrshëm të Jugosllavisë. Dhe urrejtja sa vinte e shtohet në shpirtin e djaloshtit. Por vetëm urrejtja nuk mjaftonte. Tradita e fortë patriotike e familjes së madhe Hajrizi dhe sidomos ndikimi që pati tek ai vëllai i madh Zeqiri, një veprimtar i shquar i çështjes kombëtare, ishin vendimtare në formimin e tij patriotik e atdhetar. Por ai do shkonte shumë më larg.

Ai e ndjeu qysh në shkollën normale nevojën e një organizimi tepër serioz të një fronti rezistence kundër pushtuesit. Dhe me 3 mars 1973, në shtëpinë e vëllait Bahtir Hajrizi në Prishtinë, u formua organizata Grupi revolucionar i Kosovës, një nga organizatat me serioze me jetën më të gjatë në historinë e lëvizjes ilegale. E vlerësuar si “Bërthama e revolucionit në Kosovë”. Një vit kjo organizatë u udhëhoq nga Kadri Osmani dhe mbas arrestimit të tij, për 8 vjet me radhë u udhëhoq nga Mehmet Hajrizi, deri në arrestimin në fund të vitit 1981. Së bashku me Mehmetin u arrestua dhe u dënua me 11 vjet burg edhe djali i vëllait, Jahir Hajrizi.

Para disa ditësh nën përkujdesjen e Shoqërisë “Lëvizja” u përkujtua 50-vjetori i themelimit të kësaj organizate. U përkujtuam me nderim dhe respekt dëshmorët e rënë për liri nga kjo organizatë, si dhe u vendos një pllakë përkujtimore në vendin e themelimit.

Të flasësh për Mehmetin nuk mjafton një artikull. Me bindje të patundshme do të thoja se të gjithë ata që e njohin jetën dhe veprimtarinë e tij, ata që kanë punuar e që kanë luftuar bashkë me të, ata që kanë vuajtur dënimet e gjata me të, si dhe ata që e njohin dhe e kanë parë konkretisht kontributin e jashtëzakonshëm që ai dha gjatë konferencës së Rambujesë, por edhe më vonë në rindërtimin e vendit, do bien në një emërues të përbashkët: Mehmet Hajrizi është historia e gjallë e Kosovës për liri dhe pavarësi. Një njeri i pathyeshëm për çështjen kombëtare. I pathyeshëm në drejtësinë dhe urtësinë e tij. I pathyeshëm në luftë. I pathyeshëm në paqe.

Do të bien në një mendje edhe ata që nuk e thonë dot me zë këtë të vërtetë të madhe, por që vetes nuk ia fshehin dot. Mehmet Hajrizi është historia e gjallë e Kosovës që e ka lënë të shkruar në mijëra e mijëra faqe të publicistikës së tij të shkëlqyer, por mbi të gjitha e shkruar me ndershmëri dhe vërtetësi. Një punë titanike, shpesh herë në dhimbje nga pasojat që i ka lënë burgun i gjatë. Një pasuri kjo e paçmuar për historinë e Kosovës dhe për brezat që do të vijnë. Një punë që vazhdon ta bëjë me përgjegjësi dhe përkushtim, sepse ai e di mirë, haresa do të ishte një krim shumë i madh që do t'i bëhej Kosovës dhe historisë së saj të përgjakur. Por edhe më keq siç thuhet rëndom, haresa të çon në përsëritjen e mynxyrës.

Do doja të ndaja me ju një copëz nga korrespondenca ime me Mehmetin, më 16 tetor 2011, mbasi lexova librin e tij “Sprova të Çlirimit”.

Idashur Mehmet,
e lexova me kënaqësi dhe vëmendje librin tënd “Sprova të Çlirimit”. Urimet e mia më të mira! Ju me siguri keni marrë shumë urime e përgëzime për veprën tuaj, por urimin me të bukur ua bën gjuha



jonë, gjuha shqipe, e cila ju falënderon që e përdorni aq bukur, duke i bërë një shërbim shumë të madh. Dëshiroj miqësisht të ndaj me ju emocionet që provova në faqet e këtij libri si dhe mbresat që më lanë shumë ngjarje që ju përshkruani, shumë mendime tuajat, shumë kritika të ndershme që ju i bëni me qëllimin e mirë për të ndërtuar dhe për të bashkëpunuar. Të gjitha këto përputhen plotësisht me vizionin tim për politikën dhe politikanin, atdhedashurinë dhe sakrificën, luftëtarin për çështjen e drejtë dhe vetëmohimin.

Nuk marr përsipër të bëj analizën e veprës suaj sepse atë në mënyrën më të saktë e keni bërë ju vetë në parathënien e librit. Po shkëpus një paragraf nga parathënia jo vetëm sepse këtu është thelbi i së gjithës, por sepse më mrekulloi mënyra e shprehjes në pesë rreshta të kësaj të vërtete të madhe. « ... Kosova kaloi nëpër sprova të rënda të çlirimit nga sundimi i huaj, por edhe nga vetvetja. Ajo duhej të këpuste prangat e robërisë së gjatë e vargonjtë e shpirtit dhe të çlirohej nga mentalitetet e robit e nga konceptet e vjetra... Kosova e pasurive dhe e varfërisë, Kosova e krenarisë dhe e mjerimit, e trimërisë dhe e frikës, e majave dhe e batakut; ky është Atdheu ynë i të kundërtave në realitet dhe në faqet e këtij libri. » Dua t’ju falënderoj sinqerisht që forcuat edhe më shumë bindjen time, që për të shkruar apo për të bërë një film për Kosovën dhe luftën e saj për pavarësi, çelësin duhet ta gesh te Pranvera e vitit 1981. Ju i analizoni shumë qartë shkaqet që « ... çuan natyrshëm dhe në mënyrë të pashmangshme në Pranverën Shqiptare 1981... ». Edhe pse e përgjakur, ajo Pranverë mban në gjirin e saj të kaluarën dhe të ardhmen e Kosovës.

Nëpër faqet e librit tuaj janë të gjitha stinët: Dimri i ftohtë e i rëndë i pushtimit, Pranvera e përgjakur e lirisë, Vera e masakrave barbare, kur kriminelin Milosheviq, duke ndjerë fundin, i vinte flakën gjithçkaje deri tek arat e mbjella me të lashta, Vjeshta e drithëruar që sheh përpara një dimër akoma më të rëndë. E nëpër të gjitha këto stinë që kryejnë rotacionin e tyre nëpër

vite, unë pashë njeriun që beson me vetëmohim në idealin e lirisë, heroin e heshtur që jetën ia ka kushtuar këtij ideali, njeriun që nuk e trembi as burgun, as lufta dhe as paqja. Njeriun që politikës i veshi moralin.

Pashë nënat e dëshmorëve “...shamibardhat që sfiduan zinë”. Pashë fëmijët e luftës që Kosova duhej t’u jepte buzëqeshjen. Pashë invalidët e luftës që kërkojnë dinjitetin dhe prekem nga thirrja juaj: “...para se të humbim njëri-tjetrin rrugëve të errëta, le të lëmë takim te varret e dëshmorëve, se më lehtë bashkohemi dhe e gjejmë dritën e shtegtitimit kthesave të historisë!” Aty në takimin e shenjtë, unë pashë Drenicën e Adem Jasharit e të Azem Galicës. Pashë Nuh Berishën dhe Rexhep Malajn, duke luftuar trimërisht, me penë edhe me pushkë. I pashë të dy edhe “atë mëngjes të acartë duke luftuar në agun e përflakur”. I pashë kur ranë si burrat me armë në dorë. Por, nuk i mbajta dot lotët kur “... kortezhi funeral po përcillte ngadalë në varrezat e Gjilanit trupin e Mehmet Malajt, plakut të burrërisë shqiptare, shok lufte i dëshmorëve dhe baba i Rexhepit. Të gjithë prinin që arkivoli të ulej pranë varrit të të birit, Xhepës së shtrenjtë, por ai plot dinjitet vazhdoi rrugën sipas amanetit të të zotit, drejt Nuh Berishës, të varrosur me urdhër të policisë qindra metra më larg. Një shkëmb i patretshëm i Kikës legjendare u lëshua në gjirin e gurtë pranë birit tjetër dhe sfidoi ndarjen e dhunshme. Mehmet Malaj u bashkua me një simbolikë antologjike me të gjithë bijtë e bijat tij, të rënë për kauzën e madhe të lirisë... ».

Do doja ta lexoja dhe librin tjetër “Historia e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981”. Shpresoj ta gjej kur të shkoj në Tiranë.

Me respekt dhe mirënjohje, Margarita, Toronto.
Më ka ngelur në mendje një episod nga burgun që ma ka treguar Mehmeti me atë modestinë dhe shkujdesjen kur fliste për veten, po që mua më ka ngelur në mendje. E kishin futur në burg me të dënuar ordinerë. Si Krishti. Gjatë kohës së hetuesisë e mermin çdo

ditë në pyetje nën tortura çnjerëzore. Në atë burg ndodhej dhe një djali i komunitetit Rom. E kishin dënuar për vjedhje. Nga varfëria djali rom me shokët i zinin pritë trenit që transportonte këpucë, dhe kur treni ndalonte në semafor afër stacionit, ata hipnin në vagon dhe hidhnin poshtë kutitë me këpucë të cilat me vonë i shisnin. Djali Rom me intuitë, me një zgjuarsia natyrale, dhe me një zemër të madhe e kuptoi se kush ishte Mehmet Hajrizi. Dhe sa herë që Mehmetin e binin në dhomë mbas hetuesisë, ai i lutej gardianëve t’i jepnin një kokërr qepë nga dollapi i Mehmetit në korridor dhe ia vinte atij në pjesët e mavijosura e të ënjtura të trupit ku e kishin goditur.

– Baca Mehmet ja ta vë edhe këtu. Oh, si të paskan bërë të poshtrit! Oh, Oh!

– Po lëre mor Sefë se ata këtë punë kanë përditë! – ia kthente Mehmeti i prekur thellë nga kujdesi i djalit. Po djali nuk reshte e nuk reshte së kujdesuri për bacë Mehmetin.

Plagët i duronte Mehmeti, por kur vinte lajmi në burg për humbjen e shokëve, (shpesh herë lajmi vinte me shumë vonesë,) dhimbja ishte e padurueshme. Ashtu si ishte e padurueshme dhimbja për nipin e tij Naser Hajrizi dhe Asllan Pireva dy djem fare të rinj, të cilët ranë heroikisht në demonstratën e madhe të vitit 1981, e treguar në librin e tij kushtuar Naserit, Bir i Atdheut.

Duke i uruar Mehmetit jetë të gjatë, shëndet, lumturi me familjen e bukur, i rrethuar nga nipër e mbesa që e duan aq shumë, me Haxheren në krah, shoqen e tij besnike të jetës dhe të luftës, po e mbyll me fjalët e fundit të intervistës që Adnan Merovci i bëri në muajin shkurt të këtij viti me Mehmet Hajrizin.

– Shikues të nderuar, ky është Mehmet Hajrizi! I saktë, i shkurtër, fjalëpak po punë shumë. Një njeri i devotshëm i çështjes kombëtare. Ju, gjeneratat e reja, mos e harroni këtë emër: Mehmet Hajrizi. Shumë bukur!

Faleminderit Adnan Merovci për këtë intervistë dhe këtë mesazh kaq të bukur!

Toronto, Kanada.

Dita Historike e Shkollës Shqipe



Hasan MUJAJ

Shtatë Marsi i vitit 1887. Një ditë madhështore. Historike e kombëtare. Arsimore e diturore. Kulturore dhe etikore. Atë ditë zuri e filloi një rrugëtim i ri zhvillimi për gjuhën shqipe, për shqiptarët; një ndriçim i domosdoshëm për ta ruajtur dhe kultivuar më tej identitetin kombëtar, i cili duhej të kalonte nëpër një terren të rrëshqitshëm e me shumë pengesa e kthesa për t'i hapur hullitë e vatrave të diturive.

Zatën përkushtimi i këtyllë është shumë më i hershëm dhe rrënjët e tij janë shumë më të thella sesa ato të vitit 1887. Kundruar nga ky vëzhgim, mund të thuhet se gjurmë të shkollës shqipe, sipas ca shënimeve, janë gjetur që nga gjysma e parë e shek. XVII madje edhe më herët.

Duke e ndjekur fillimin e ndërtimit të rrugës historike të shkollës shqipe, studiuesi amerikan Edwin Jacques, në veprën Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, shkruan: "Shkolla e parë e dokumentuar në gjuhën shqipe u hap në Velje – Vele të Mirditës më 1632. "Sipas këtij autori, po në këtë vit, një shkollë shqipe u hap edhe në Kurbin. Ai shkruan edhe për shkollën e Pllanës (një fshat afër lumit Ma) të vitit 1638 dhe për një tjetër në Troshan një vit më pas. (Nga Gazeta Mirdita nr. 1, më 26 tetor 2013)

Edhe Atë Donat Kurti kishte shkruar në revistën Hylli i Dritës për „ të parën shkollë shqipe të hapur më 1638 në Pllanë. "Ai shkroi edhe për shkollën e Blinishtit dhe të Shkodrës. Shkrimtari zulmëmadh Ismail Kadare kishte shkruar: „ ... kleri katolik në Shqipëri nuk rreshti së punuari për të mirën e kombit e të gjuhës." Edhe pse në thelb këto shkolla qenë të natyrës së fesë katolike shqiptare, sipas të dhënave të sipërshtuara, aty mësohej gjuha shqipe si themel i identitetit kombëtar që është, ruajtja e së cilës

dëshmohet edhe nga Kuvendi i Arbënit, i mbajtur në vitin 1703 në të cilin u vërtetua edhe funksioni kombëtar e arsimor i kishës katolike shqiptare.

Ky Kuvend u mbajt sipas urdhrat të Papës shqiptar Papa Klementi XI – Albani. Tekstet e këtij Kuvendi u botuan edhe në gjuhën shqipe në vitin 1706. Ato zgjeruan dhe përfunduan themelin e përdorimit dhe të zhvillimit të gjuhës shqipe, që ishte vënë nga autorët e letërsisë së vjetër shqipe: F. Bardhi, P. Bogdani, P. Budi etj., i cili (themel) e thelloi dhe e shpuri përpara veprimtarinë kombëtare, arsimore e kulturore si dhe qëndresën e pathyeshme shqiptare kundër pretendimeve osmane, që synonin shkombëtarizimin e shqiptarëve. Përpjekjet për të hapur shkolla në gjuhën shqipe u trupëzuan edhe në Kosovë. Në vitin 1665, nga përkujdesja e Andrea Bogdanit, u hap një shkollë në Janjevë mësuesi së cilës ishte prifti Pjetër Mazreku. Një shkollë shqipe u hap edhe në Prizren në vitin 1889. Mësues i saj qe Mati Logoreci.

Në vitin 1861 u hap shkolla françeskane në Shkodër në të cilën mësohej edhe gjuha shqipe si lëndë mësimore. Aty ndoqën mësimet, ndër të tjerë, edhe Faik Konica, vëllezërit Myzafer dhe Arshi Pipa etj.

Shkolla e Voskopojës Voskopoja, sot një fshat i varfër rreth njëzet km larg Korçës, nga viti 1744, ishte një nga qendrat e zhvilluara shqiptare e zejeve të ndryshme, sidomos e njohur si qendër e madhe tregtare. Ajo kishte rreth tridhjetë mijë banorë, por shquhej edhe si vatrë e arsimit dhe e trashëgimisë kulturore. Ajo kishte edhe shkollën e quajtur Akademia e Re. Mësimi në këtë shkollë zhvillohej në gjuhën shqipe dhe greke. Drejtues të parë të saj qenë: Sevast Seontiadhi e më pas Teodor Kavalioti. Kuadri mësimdhënës: Dhanil Haxhiu, Kostë Berati, Teodor Haxhifilipi etj.

Akademia e Re kishte bibliotekën e pasur, shtypshkronjën, konviktin e nxënësve dhe kushte të favorshme të veprimtarisë.

Historiani i spikatur Aleks Buda, këtë burim dritëdhënës të arsimit e të kulturës, e quajti: "Djep i Rilindjes Kombëtare; iluminizëm i hershëm" etj. Në Voskopojë rrodhi një veprimtari shumë e rëndësishme për zhvillimin dhe përdorimin e gjuhës shqipe; u krijua një alfabet i veçantë për shkrimin e saj; aty u shqipëruan Dhiata e Re dhe Dhiata e Vjetër etj. Mirëpo, njëzet e pesë vjet pas veprimtarisë së ndritur arsimore e kulturore, Perandoria Osmane, në vitin 1769, bëri djegien dhe rrënimin e tërësishëm të burimit të arsimit në gjuhën shqipe!

Sikundër mund të shihet, të dhënat flasin se dyqind e pesëdhjetë e pesë vjet përpara shkollës së Korçës, në disa krahina të Shqipërisë veriore, u hapën shkolla në gjuhën shqipe. Në themelin e këtyre shkollave qëndronte ideali i patrandur i priftërinjve mësues për ta ruajtur, për ta mësuar dhe për ta zhvilluar gjuhën shqipe – këtë tipar kombëtar të shpirtit shqiptar. Dhe, vazhdon udhëtimi i gjatë, tejet i gjatë i përforcimit të shkollës shqipe.

Arritja më e madhe në këtë lëvizje lapidare kombëtare u shënua nëntë vjet pas Lidhjes së Prizrenit, më 7 Mars të vitit 1887 kur u hap shkolla shqipe në Korçë, mësues i parë i së cilës qe Pandeli Sotiri. Poeti e filozofi i mirënjohur rilindës-Naim Frashëri, këtë arritje madhështore e hyjnizoi dhe e poetizoi me vargjet:

"Gëzohuni që erdhi kjo ditë

Kaq e mirë e kaq e mbarë,
Na sjell të gjithë mirësitë."

Nuk munguan as abetaret e para për shkollat shqipe. Njëri nga pararendësit e Rilindjes Kombëtare – Naum Veqilharxhi shkroi abetaren e quajtur Evetari në vitin 1844, e cila më e zgjeruar, u ribotua

një vit më vonë. Kostandin Kristoforidhi, në vitin 1867, botoi dy abetare: njëren gegërisht e tjetren toskërisht. Rilindësit: Jani Vreto, Sami Frashëri, Pashko Vasa etj. botuan veprën "Alfabetarja e gjuhës shqipe" në vitin 1879 etj.

Interesimi për shkollat shqipe sa vinte e po ngrihej si një nga veprimtaritë më të rëndësishme të Rilindjes Shqiptare. Katër vjet pas shkollës së Korçës, në tetor të vitit 1891, po në këtë qytet, nga përkushtimi i motrave Sevasti e Parasqevi Qiriazi si dhe i vëllait të tyre- Gjerasim Qiriazi dhe me ndihmën e madhe të Naim Frashërit, u hap shkolla shqipe e vashave. Duke e ndjekur këtë mision të lartë drite, disa shkolla u hapën edhe në krahinën e Kolonjës.

Shkolla normale shqipe e Bukureshtit

Kontributi i mërgatës sonë për ta zhvilluar veprimtarinë kombëtare edhe jashtë etnisë shqiptare, ishte i madh. Shumë i madh. Ai u shtri dhe u konkretizua në disa fusha: për të hapur shkolla në gjuhën shqipe; në vitin 1892, në Bukuresht, nga iniciativa e shoqërisë "Drita", u hap Shkolla Normale edhe në gjuhën shqipe (Scuola Normale Albaneze) në të cilën mësimi zhvillohej shqip dhe rumunisht. Kjo ishte arritje historike. Drejtor i kësaj shkolle ishte veprimtari prominent për hapjen e shkollave shqipe – Nikolla Naço. Në të jepnin mësim edhe profesorë universitarë. Aty ndoqën mësimet, ndër të tjerë, edhe: Dervish Hima, Jashar Erebara, Mihal Grameno, Aleks Stavri Drenova, Lasgush Poradeci, Shahin Kolonja etj., të cilët, siç dihet, u bënë emra të mëdhenj të veprimtarisë kombëtare, letrare dhe publicistike të Rilindjes Shqiptare.

Ndonëse këtë shkollë e kundërshtonin disa autorë të spikatur rilindës si: Jani Vreto, Visar Dodani, Lumo Skëndo (Mithat Frashëri) nga mospajtimet që kishin me drejtorin e saj, e vërteta është se shtatëmbëdhjetë vjet përpara Normales së Elbasanit, për të cilën në shumë tekste shkollore thuhet se është shkolla e parë e mesme shqipe, i kishte hapur dyert Normalja e Bukureshtit tek u përgatitën mësuesit shqiptarë.

Veprimtari të pasur kombëtare zhvillonin edhe shoqëritë kulturore si p. sh. Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqipe e njohur edhe me emërtimin Shoqëria e Stambollit e formuar në vitin 1879, e cila hapi degën edhe në Bukuresht me emrin "Drita" e më pas "Diturija". Për t'i dhënë zë afirmativ lëvizjes shqiptare, mërgata krijoi e botoi edhe gazeta e revista madje edhe në gjuhë të huaja p. sh.: Albania në Bruksel, Kombi dhe Dielli në ShBA,

Flamuri i Arbërit në Napoli etj.

Shkolla Normale e Elbasanit

S'ka dyshim se Normalja e Elbasanit, e cila filloi punën më 1 dhjetor të vitit 1909, shënoi një arritje të madhe në fushën e arsimit shqip. Ajo u bë institucioni më ndriçues i arsimit shqip të asaj kohe. Drejtor i parë i saj ishte Luigj Gurakuqi. Në këtë shkollë dhanë mësim studiues e krijues me kredibilitet të lartë shkencor të gjuhës dhe të letërsisë shqipe si p. sh. : Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Luigj Gurakuqi, Simon Shuteriqi, Sotir Peci, Qamil Guranjaku etj. Në të mësonin nxënës vivesh të ndryshme shqiptare, një numër i madh i të cilëve ishte nga Kosova, të dërguar në këtë shkollë me iniciativën dhe me përkrahjen e Hasan Prishtinës në përpjekjet e tij të mëdha për të siguruar kuadër mësimdhënës me qëllim që të hapeshin shkolla shqipe edhe në Kosovë. Shkolla botonte edhe gazetën "Normalisti". Sado që ishin të mëdha tendencat dhe masat represive të qarqeve antishqiptare për të penguar mësimin në gjuhën shqipe dhe për t' i mbyllur shkollat shqipe, aq më e madhe dhe mbizotëruese ishte gatishmëria e therorizimit për t'u vënë në mbrojtjen e tyre. Vërtet është i gjatë vargu i viktimitave të shkollave shqipe, që u flijuan për t'i mbrojtur burimet e diturive p. sh.: Pandeli Sotiri, Pjetër Nin Luarasi, Papa Kristo Negovani, Luigj Gurakuqi, Shtjefën Gjeçovi, Fazli Greiçevci, Haki Pavata, Feriz Blakçori, Halit Geci e qindra të tjerë, të cilët prora do të mbesin ndër shëmbëlltyrat më të ndritura kombëtare. Dhe jo vetëm kaq.

Viktima të shkollës shqipe janë edhe ata veprimtarë të lëvizjes kombëtare shqiptare, që bënë rezistencë kundër mbylljes me dhunë të shkollës shqipe nga policia serbe në fshatin Uçe të Istogut me ç' rast ranë dëshmorë: Muharrem Hyseni, Hasan Hysenaj dhe Bajram Hoxhaj më 21 janar të vitit 1992.

Gjithë ç'u tha në këtë vështrimth, del e kuptueshme se edhe përpara shkollës së Korçës u hapën disa shkolla shqipe në krahinat veriore të Shqipërisë e gjetkë, të cilat, ndonëse vepronin në rrethana të ndërlikuara të kohës përkatëse dhe të përgjuara e të rrënuara nga pushtimi osman, ato janë pjesë e ndritur e historisë shqiptare dhe pararendëse e nxitje dinamike të zhvillimit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Historia nuk duhet të reduktohet. Jo. Ajo duhet të ruhet dhe të kapet e tëra. Edhe emërtimi Dita e Mësuesit sikur i përjashton mësueset. Kjo është e padrejtë, andaj do një riformulim gjithëpërfshirës p. sh.: Dita e arsimit, Dita e shkollës shqipe etj.

Kur e arrijmë kulmin e jetës sonë?



Nga Enuma OKORO

Gazetari amerikan Don Lemon u kritikua shumë kohët e fundit kur deklaroi se Niki Halej, kandidatë presidenciale nga radhët e Partisë Republikane, 51-vjeçe, që ka bërë thirrje për kryerjen e testeve të aftësisë mendore për politikanët më të moshuar se sa 75 vjeç, nuk ishte as vetë "në kulmin e saj".

Ai theksoi se "një grua mund të konsiderohet në kulmin e saj në të 20-at dhe të 30-at, apo ndoshta në të 40-at". Lemon, që është vetë 56 vjeç, e mbrojti deklaratën e tij duke thënë se kjo ishte ajo që tregon edhe një kërkim rastësor në internet. Natyrisht, edhe unë vetë kërkova në google mbi pyetjen "Kur një grua është në kulmin e saj?", dhe rezultati i parë që del tani është pretendimi i Lemon.

Duke lënë mënjanë paragjykimet patriarkale, seksiste dhe moshore të komentit të Lemon, nuk është ndonjë lajm që shoqëria perëndimore është shumë e fiksuar pas rinisë së përpjetshme. Por ky moment më nxiti të mendoja mbi këmbënguljen e fortë dhe deri diku qesharake të jo pak grave për të dukur sa më të reja.

Sikurse pyeti me të drejtë kolegu i Lemon në atë emision: "E për çfarë kulmi po flasim?". Çdo stinë e jetës sonë ka vokacionin dhe dhuntinë e veta. Prandaj çfarë mund të humbasim të gjithë ne si individë dhe shoqëri, kur e kufizojmë kaq shumë imagjinatën tonë, dhe kur luftojmë kundër procesit natyror të plakjes?

Tabloja me titull "The First Wrinkle" (Rrudha e parë) nga piktori impresionisti italian Federiko Zandomenegi, tregon një grua të re, epshore, që është e përqendruar tek një pasqyrë dore, duke ekzaminuar në detaje fytyrën e saj. Përballë saj shohim një kavanoz, me sa duket i mbushur me një lloj kremi.

Pra jemi duke parë një skenë intime. Jo vetëm sepse e shohim gruan e veshur me këmbësorë e saj

të lirshme të natës që i rrëshqet mbi njërin sup, por edhe sepse po e shohim në një moment meditimi të thellë mbi veten. Duke njohur presionet me të cilat përballen gratë për ta zgatur sa më gjatë rininë e tyre, nga frika se mos plaken më shpejt, unë nuk mund të mos pyes veten se çfarë mendimesh mund të rrjedhin nëpër kokën e saj.

Në një moment të jetës sonë si të rritur, ne mund të fillojmë të ndeshemi me një përplasje midis asaj se kush ndiejmë që jemi nga brenda, dhe asaj që ne apo ose bota na sheh nga jashtë. Plakja është diçka e pashmangshme. Trupat tanë e fillojnë procesin e tyre të konsumimit që nga momenti që lindim.

Por kultura perëndimore na mëson që sapo të fillojmë të njohim shenjat fizike të plakjes, atëherë është koha për t'u shqetësuar. Në vend se të pranojmë mundësitë për rritje shpirtërore që mund të vijnë nga plakja si proces natyror, bota na inkurajon të përpqemi të zgjasim stinën e jetës që në fakt janë duke ecur natyrshëm në rrjedhën e tyre.

Në vend se ta falënderojmë trupin tonë që na ka sjellë deri këtu, dhe të vërejmë dhe gëzohemi për avantazhet që vijnë me plakjen, ne fillojmë një mini-luftë kundër trupit tonë, duke luftuar kundër vetes në mënyra që janë të lodhshme, si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht. Unë e dua shumë tablonë tjetër të famshme "Burimi i rinisë" (1546) të Lukas Kranash Plakut. Ai përfaqëson një përshkrim sa komik aq edhe të tmerrshëm të denigrimit shekullor që i ka bërë plakjes bota perëndimore, por dhe i standardeve seksiste dhe patriarkale me të cilat vendosen vlerat e grave të reja dhe të vjetra.

Skena në atë tablo zhvillohet në një peizazh të gjerë. Në sfond shtrihet një varg malor, së bashku me një kështjellë të largët mbi një kodër. Në qendër ndodhet një pishinë e madhe e cekët, me një shatërvan të vogël të ngushtë në mes. Ana e majtë e pikturës është e mbushur me gra të moshuara.

Ata mbërrijnë atje duke transportuar ujë me tezgja, kuaj dhe karroca dore. Disa nga gratë janë duke u inspektuar apo zhveshur përpara se të hyjnë në pishinë. Ndërkohë, ana e djathtë e tablosë është plot me vajza të reja. Gratë e moshuara transformohen nga ujërat kuruese, duke dalë të rinuara prej andej.

Pasi hyjnë brenda një tende aty pranë, ato vishen me fustane të reja, dhe gjejnë sërish në dispozicion një shumëllojshmëri përvojash të këndshme dhe sensuale. Disa marrin pjesë në gosti dhe vallëzime. Ne shohim edhe një grua të re duke u joshur nga një djalë i ri.

Piktura sugjeron që nëse mund të lihet pas pleqëria, atëherë jeta jonë do të jetë sërish plot kuptim, marrëdhënie dhe aktivitete jetëdhënëse. Ky zhvlerësim i të moshuarve, ka një jehonë të fortë në kulturën e sotme, e cila na mëson që t'i hedhim poshtë me lehtësi dhe pa shumëceremoni gjërat që besojmë se e kanë tejkaluar dobinë e tyre, përfshirë njerëzit.

Shumëçka konsiderohet sot e zëvendësueshme: ne nuk jemi një shoqëri që vlerësojmë realisht potencialin afatgjatë të gjërave. Ne i ndryshojmë tanë çdo vit telefonat për versionin më të fundit. Ne presim pemë që janë shekullore, për të ndërtuar në çdo hapësirë të gjelbër të disponueshme. Ne e ndryshojmë garderobën tonë në çdo sezon të ri të modës. Dhe ishëmangim njerëzit për të cilët nuk jemi më të interesuar.

Ndonjëherë duket sikur po e humbasim kuptimin tonë mbi atë që do të thotë të vlerësoh diçka, dhe kjo gjë vërehet në çdo fushë të jetës, nga mjedisi, njerëzit, dhe deri tek shpallja e jetës sonë. Mua më ngjan me një krizë shpirtërore dhe të imagjinatës.

Perspektiva hapësinore e pikturës dhe numri i madh i njerëzve në këtë tablo, synojnë të ekzagjerojnë natyrën komike dhe tragjike të këtij fiksimi pas rinisë së përpjetshme. Në

mungesën e vullnetit tonë për t'u përballur me sfidat e pashmangshme që vijnë me plakjen dhe realitetin e vetë vdekshmërisë sonë si qenie, ne rrezikojmë të humbasim mundësinë paralele për forcim shpirtëror dhe për takime të thelluara të jetës, të cilat gjenden të fshehura në peripecitë e jetesës.

Ne e ngatërrojmë rininë me përsosmërinë dhe përsosmërinë me jetën e mirë. Nëse e shihni me vëmendje pikturën, do të shihni 2 plaka në anën e majtë, që të dyja pjesërisht të mbështjella me peshqir. Njëra ulet buzë shkallëve të pishinës, me gjunjtë e saj të mbledhur kruspull në gjoks; ndërsa tjetra i ka zhytur këmbët në ujë dhe po bisedon me një grua plotësisht të veshur, e cila duket se po përpqet ta bindë që të zhytet plotësisht.

Këto dy gra hezituese, janë për mua elementët më intrigues të kësaj pikturë. Ndonëse tashmë të zhveshura, ata nuk duken plotësisht të bindura se plakja është aq kufizuese dhe e padëshirueshme sa synon që të na e imponojë shoqëria. Këto dy gra ngurruese, mund të kenë fituar mençurinë për të përfytyruar liritë dhe mundësitë e reja që i presin në vitet e tyre të mëvonshme.

Një vepër tjetër më ka bërë shumë përshtypje në lidhje me këtë temë titullohet "Le Vecchie Comari" (Gratë e moshuara) nga piktorja italiane e shekullit XX-të Felice Kasorati. Tetë gra të moshuara, të mbuluara nga qafa deri në kyçin e këmbës me fustane, shalle dhe batanije, janë mbledhur së bashku deri në skajet e kanavacës.

Njëra prej tyre është kthyer me fytyrë nga ne, me dorën e saj në ijë, një gjest që ilustron dhimbjet fizike të plakjes. Një grua tjetër shfaqet e ulur dhe mbështjellë me batanije, me vështrimin e saj të ashpër drejt dyshemesë dhe si e përhumur në soditje. Gjashtë gratë e tjera qëndrojnë në këmbë, disa me ndihmën e një bastuni.

Ajo që adhuroj më së shumti në

këtë tablo janë shprehjet në fytyrat e grave. Një grua me një shall rozë rrotull qafës së saj, na vështron me një buzëqeshje të sigurt. Një grua tjetër në anën e majtë na vështron me një buzëqeshje disi ironike, si të pyeste shoqet e saj se për çfarë është gjithë kjo bujë.

Por është figura qendrore, një grua e veshur e tëra në të zeza dhe që mban një bastun, ajo që duket se e përmbledh gjithë atmosferën e tablosë. Koka e saj është përkulur dhe na shikon me bisht të syrit, me një buzëqeshje djallëzore e të fshehtë. Këto gra të moshuara janë të kënaqura në vetvete, dhe duket se dinë gjëra që ne nuk i dimë.

Buzëqeshja e tyre tregon se ne do ta zbulojmë se çfarë dinë ato, vetëm nëse kemi fatin të arrijmë moshën e tyre. Por ndërkohë, ajo dhe mikeshat e saj ka të ngjarë të kenë gjëra të vlefshme për të na mësuar ne të tjerëve. Një pjesë e dhuratës së plakjes, të kultivimit të njëfarë mençurie nga përvoja e jetës, është ajo që na ofron ne që jemi ende në rrugën tonë drejt asaj faze të jetës.

Kuptohet, jo të gjithë ata që plaken fitojnë mençuri apo edhe pjekuri, por një jetë e gjatë sjell shpesh mësim të vlefshme. Nuk mund të mos mendoj se pavarësisht sfidave që bart, mosha e thyer përmban edhe ftesën e saj për të zbuluar një shpallje të re të vetes dhe për të përqafuar më lehtë misterin e pakuptuarit të gjithçkaje.

Shpresa është që ndërsa plakemi, mund të hyjmë në atë sezon më me hijeshi, më të përgatitur për t'u përballur me pasigurinë dhe kompleksitetet e jetës, me më pak frikë dhe ankth që ato gjëra mund të shkaktojnë në vitet tona të rinisë. Dhe me një aftësi më të thellë për të kapur bukurinë e fshehur tek të gjitha gjërat: bukuria është ajo që ndihmon në zgjerimin e imagjinatës sonë, dhe na bën thirrje për një reflektim më shpirtëror për të jetuar me veten dhe të tjerët.

"Financial Times" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova synon fitore ndaj Bosnjë-Hercegovinës

Sonte në kryeqytet Kosova synon fitore ndaj Bosnjë-Hercegovinës. Hendbollistët Kastriot Jupa dhe Drenit Tahirukaj kanë bërë me dije se motivi te hendbollistët “dardanë” është i madh dhe për ta arritur synimin presin përkrahje të madhe nga shikuesit. Ndeshja zhvillohet me fillim nga ora 20:15 dhe i takon grupit të shtatë të fazës së dytë kualifikuese për “Euro 2024”

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll përballet sonte (e mërkurë) në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë me Bosnjë-Hercegovinën nga ora 20:15. Hendbollistët nën urdhrat e përzgjedhësit Bujar Qerimi kanë punuar në aspekte taktike të përgatitjes së lojës,

ndërsa janë shfaqur të uritur për ta dhënë maksimumin me synim për ta fituar ndeshjen. Ndeshjet i takojnë grupit të shtatë të fazës së dytë kualifikuese për “Euro 2024”. Në grup janë edhe Mali i Zi dhe Sllovenia, që kanë nga dy fitore, përkatësisht nga katër pikë. Kosova e Bosnja janë pa pikë. Synimi i “dardanëve” është vendi i tretë që mund të jetë i



mjaftueshëm për kualifikim. Një nga hendbollistët në kampion e Kosovës, Kastriot Jupa, ka thënë se të gjithë janë të motivuar për sukses, ani pse kundërshtari ka potencial. “Jemi të motivuar dhe shumë të uritur për sukses. E

dimë që përballë kemi një kombëtare cilësore, por edhe ne kemi cilësi dhe përvojë. Përkushtimi është maksimal, ndërsa synimi dihet - fitorja. Presim të ketë numër të konsiderueshëm shikuesish dhe

që përkrahja nga tribunat të jetë e madhe. Premtojmë që përkrahjen do ta shpërblejmë me angazhim maksimal dhe lojë të mirë”, ka thënë Jupa. Për ndeshjen ndaj Bosnjës foli edhe hendbollisti Drenit Tahirukaj, i cili po shquhet me efikasitet te Kreuzlingeni në elitën e Zvicrës në hendboll. “Synimet tona janë të qarta, që të arrijmë të marrim pikë në të dy ndeshjet kundër Bosnjës. Natyrisht, jemi në palestrën tonë, në shtëpinë tonë dhe presim përkrahje maksimale. Prandaj ftojme të gjithë hendbolldashësit të jenë në numër sa më të madh në palestrën e sporteve në Prishtinë. Ju premtojmë që nuk do t’ju zhgënjëjmë”, ka thënë Tahirukaj.

PSG-ja në Gjermani kërkon kualifikimin në çerekfinale

“Epoka e re”

MUNCHEN, 7 MARS - Bayern Muncheni dhe Paris Saint-Germaini e zhvillojnë ndeshjen e dytë dhe kërkojnë kualifikimin në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Më afër këtij qëllimi është skuadra gjermane që shënoi fitore në ndeshjen e parë të zhvilluar në Paris (0-1), kurse ndeshja kthyes zhvillohet në “Allianz Arena”. Në kampin “bavarez” e dinë mirë që Leo Messi dhe Kylian Mbappe të ndëshkojnë në çdo çast. Trajneri Julian Nagelsmann ka thënë se nuk do të ketë ndonjë strategji ndryshe për t’i mbuluar yjet e PSG-së. “Ne kemi de Lig, i aftë jo vetëm të mbrojtë mirë, por edhe të shënojë. U përgjigja kështu për të thënë se

ne nuk do të futemi në fushën e lojës me idenë ta mbrojmë rezultatin e sfidës së parë. Është një fitore që të gënjen, ndaj do të hyjmë në fushë të vendosur për të shënuar, për të fituar, vetëm kështu mund t’ia dalim mbanë dhe të vijojmë në misionin tonë. Një dorë do të na japin edhe tifozët tanë”, ka thënë Nagelsmann. Bayerni në këtë ndeshje do të jetë pa Pavardin e suspenduar dhe Hernandezin, Neuerin dhe Mazraouin e lënduar. Edhe PSG-ja ka mungesa për këtë ndeshje dhe kryesorja është ajo e Neymarit që e ka mbyllur sezonin aktual. Ndërsa të lënduar janë edhe Presnel Kimpembe dhe Renato Sanches. Për ndeshjen ndaj Bayernit foli ylli i PSG-së, Leo Messi. Argjentinasi ka thënë se

në Munchen shkojnë për fitore. “Është e rëndësishme të arrijmë pas tri fitoreve që na dhanë besim dhe na lejuan të punojmë me një frymë tjetër. Ne shkojmë në Munich për të fituar. E dimë vështirësinë e sfidës, por jemi të përgatitur. Do të jetë e njëjta lojë si në ndeshjen e parë, e cila u vendos nga detaje të vogla. Skuadra ka paraqitur një imazh ndryshe javët e fundit dhe ka shpresën për t’u rikthyer dhe për ta vazhduar kursin në Ligën e Kampionëve. Ka qenë shumë e vështirë për mua të përshtatem në vitin e parë për arsye të ndryshme, por që në fillim të këtij sezoni e bëra me entuziazëm dhe dëshirë, tani jam më rehat me klubin, qytetin dhe gjithçka që është në Paris”, ka thënë Messi. Sonte (e mërkurë) zhvillohet



Formacionet e mundshme:
Bayern Munchen: Sommer; Stanisiq, Upamecano, De Lig; Coman, Kimmich, Goretzka, Davies; Sane, Musiala; Choupo-Moting.
Paris Saint-Germain: Donnarumma; Pereira, Marquinhos, Ramos; Hakimi, Ruiz, Verratti, Vitinha, Mendes; Messi, Mbappe

Të mërkurën takohen:
21:00 Bayern Munchen - Paris Saint-Germain
21:00 Tottenham Hotspur - Milan

edhe ndeshja tjetër e Ligës së Kampionëve në mes të Tottenham Hotspurit dhe Milanit. Skuadra italiane e kishte fituar ndeshjen e parë në “San Siro” me rezultat 1-0.



Faisal Al-Harhi përforcon Prishtinën

PRISHTINË, 7 MARS - Futbollisti nga Arabia Saudite, Faisal Al-Harhi, është përforcimi më i ri i skuadrës së Prishtinës. 23-vjeçari ka qenë pjesë e Al-Seeb, derisa të martën është paraqitur nga

drejtori i Prishtinës, Driton Krasniqi. “FC Prishtina ka nënshkruar kontratë me futbollistin nga Arabia Saudite, Faisal Al-Harhi. Faisal së fundmi ka qenë pjesë e Mladost DG në

Mal të Zi. Futbollisti i talentuar karrierën profesionale e ka filluar te skuadra arabe Al-Seeb. 23-vjeçari, i cili aktivizohet si mbrojtës, është njoftuar me ambientet e klubit nga drejtori

sportiv i klubit tonë, Driton Krasniqi. Pas firmosjes së kontratës është vënë nën urdhrat e trajnerit Ismet Munishi”, thuhet në njoftimin e skuadrës kryeqytetase.

Prishtina sonte fillon fazën e dytë të Ligës ENBL

PRISHTINË, 7 MARS - Sigal Prishtina do ta zhvillojë sonte (e mërkurë) ndeshjen e parë të fazës së dytë të Ligës ENBL. Prishtina do të përballet në palestrën “1 Tetori” në Prishtinë me skuadrën polake King Szczecin në çerekfinalen e

parë, që do të fillojë në orën 19:00. Ndeshja e kthimit do të zhvillohet më 20 mars. Kryeqytetasit përfunduan në vendin e katërt në Grupin A me dy fitore e katër humbje, ndërsa King Szczecin fitoi Grupin B me gjashtë fitore e

një humbje. Fituesi i kësaj përballje do të ndeshet me fituesin e çiftit Budivelnky Kyiv-BC Wolves. Kjo është hera e parë që prishtinasit marrin pjesë në Ligën ENBL dhe mund të jetë hera e parë që arrijnë në Final 4.



FC Prishtina 01, fituese e trofeut "Adem Jashari" në futsall

PRISHTINË, 7 MARS - FC Prishtina 01 është skuadra fituese e trofeut "Adem Jashari" në edicionin e 14-t me radhë të këtij turneu i cili organizohet nga Federata e Futbollit e Kosovës nëpërmjet

Komisionit të Futsallit në kuadër të manifestimeve për Epopenë e UÇK-së. Në ndeshjen finale të këtij turneu, i cili u zhvillua në palestrën "Ilaz Kodra" në Skenderaj, Prishtina 01 shënoi

fitore bindëse ndaj Malishevës me rezultat 6:1. Paraprakisht në gjysmëfinale Prishtina 01 e mundi Liqenin me rezultat 5:2, ndërsa Malisheva ishte më e mirë se Drenica me rezultat 4:3. Në fund medaljet

dhe trofeun ekipit fitues të turneut ia dorëzuan presidenti i FFK-së, Agim Ademi, gjenerali Musa Jashari dhe drejtori për Kulturë, Rini e Sport në komunën e Skenderajt, Alban Berisha.



Kosova U16 fiton kundër Andorrës

PRISHTINË, 7 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e vajzave nën moshën 16 vjeç ka shënuar fitore kundër Andorrës me rezultat 3-1. Kjo ishte ndeshja e parë e "dardaneve" të reja në "UEFA Development Tournament" që po zhvillohet nën organizim të Federatës Shqiptare të Futbollit, e ku marrin pjesë edhe Moldavia dhe Shqipëria si nikoqire. Të përzgjedhurat e Albina Rrahmanit që nga fillimi i ndeshjes ishin më të mira dhe nuk lejuan në asnjë moment që fitorja të vihej në dyshim. Rezultatit e zhbllkoi Riga Kallaba në minutën e 30. Epërsinë në 2-0 e shtoi Olsa Maçastena në minutën e 51-të. Andorra arriti ta ngushtojë epërsinë në minutën e 55-të përmes Hulia Domingos, e cila realizoi nga penalltia. Megjithatë, vetëm tre minuta më vonë Riga Kallaba shënoi sërish për ta rikthyer epërsinë prej dy golave, 3-1 që, njëherësh, ishte rezultati përfundimtar i kësaj ndeshjeje. Takimin e radhës Kosova e zhvillon kundër Shqipërisë më 9 mars në orën



14:30, ndërsa më 12 mars takohet me Moldavinë. Përzgjedhësja Albina Rrahmani pas ndeshjes u shpreh e lumtur për fitoren dhe për paraqitjen e vajzave në takimin e parë të këtij turneu. "Duke pasur parasysh që vajzat kanë pasur pak kohë të stërvitit së bashku, mendoj se ishte një paraqitje e mirë. Më gëzon shumë angazhimi që ato bëjnë, dëshira për të luajtur dhe për të dhënë më të mirën. Ato janë shumë të motivuara për t'u përmirësuar dhe ta përfaqësojnë vendin sa më mirë dhe sa më lart", ka thënë Rrahmani.

"Natyrisht, gjithmonë ka vend për përmirësim dhe pikërisht ky turne u jep mundësi ekipeve ta përmirësojnë nivelin e tyre, duke u dhënë mundësi të barabarta të gjitha lojtareve që janë të grumbulluara. Sigurisht se në ditët e ardhshme do të punojmë në disa pika në mënyrë që në ndeshjet e radhës të paraqitemi sa më mirë, por rëndësi ka që secila prej 20 futbollisteve të grumbulluara të fitojë përvojë ndërkombëtare dhe të rriten së bashku si ekip. Gjithsesi jam e lumtur që e filluam turneun me fitore", ka deklaruar Rrahmani.

Denveri hipotekon kreun në Perëndim, Bostoni dorëzohet në shtesë

DENVER, 7 MARS - Fitorja e katërt radhazi për Denverin, që mbron kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 118-113 ndaj Torontos. Ndeshje e ekuilibruar deri në fund, ku për Denverin u dallua Murray me 24 pikë e Porteri me 20. Fitore në sekondat e fundit korri edhe Miami, që mundi me rezultat 130-128 Atlantan, ndeshje ku dallimin e bëri Butleri, autor i 26 pikëve. Pas kohës shtesë humbet Bostoni, që u mund me rezultat 118-114 nga



Clevelandi, ndeshje e hapur deri në fund. Browni realizoi 32 pikë e 13 rebounde për Celticsin, por që s'mjaftuan për të fituar. Për Cavaliersin u dallua Mitchell me

40 pikë e 11 rebounde. Ndeshje spektakolare ajo që nxori fituese Philadelphia, që mundi me rezultat 147-43 Indianan (Embiid 42 pikë).

REZULTATET

Cleveland - Boston	118-114
Detroit - Portland	104-110
Indiana - Philadelphia	143-147
Miami - Atlanta	130-128
Denver - Toronto	118-113
Sacramento - New Orleans	123-108

Hamiltoni i shqetësuar: Edhe Aston Martini ishte më i shpejtë se ne

Vendi i pestë në garën e Bahreinit, duke mos pasur në asnjë moment mundësi për të dueluar për podiumin, ka bërë që shtatë herë kampioni i botës në Formula 1, Lewis Hamilton, t'i lëshojë kambanat e

alarmit. Ajo që shqetëson pilotin britanik të Mercedesit është rritja e shpejtë e Aston Martinit, që u ngjiti në podium pas dy makinave Red Bull. "E kisha frikën se gjërat në garën e parë në Bahrein nuk do të

shkonin ashtu si dëshironim. Nuk ishim shumë të shpejtë dhe nuk duam dot për një vend në podium. As Ferrari nuk ishte shumë i shpejtë, por nuk i kapnim dot. Ajo që më bëri përshtypje është se edhe

Aston Martini ishte më i shpejtë se ne. Na parakaloi me lehtësi", ka thënë Hamiltoni. "Nuk di se si ta konsideroj këtë garë të parë, nuk shoh se kemi ecur përpara, madje ndoshta kemi bërë një hap para, duke qenë se jemi forca e katërt.

Duhet të punojmë edhe më shumë, pasi nuk e kemi ritmin e makinave që janë para nesh në renditje. Diçka kemi zgjidhur, por jo gjithçka, ndaj duhet parë se ku qëndron problemi", ka thënë Hamiltoni.

SHKURT

Galatasaray me plan konkret për ta blerë Rashicën

Milot Rashica është i huazuar nga Norwich City, por klubi i Galatasarayt po shqipton çdo mundësi për ta blerë komplet kartonin e futbollistit nga Vushtrria. Mediet turke mësojnë se gjiganti turk është i gatshëm t'i ofrojë 4,5 milionë euro për kartonin e përfaqësuesit "dardan". Por, klubi nga Championshipi anglez ka kërkuar kohë para se të vendosë nëse do ta shesë apo jo ish-futbollistin e Werder Bremenit. Negociatat në mes të palëve do të vazhdojnë në javët apo muajt në vazhdim. Nëse Norwichi nuk rikthehet në Premierligë, Rashica nuk do të pranojë të rikthehet në klubin anglez, ndonëse preferenca e tij është qëndrimi në Stamboll. 26-vjeçari ka zhvilluar 18 ndeshje me klubin turk në këtë edicion deri tash, ndërsa i ka realizuar tre gola dhe ka kontribuar me tri asistime.

Përfundon sezoni për Neymarin

Problemet fizike kanë qenë pengesa më e madhe e Neymarit që prej kohës kur u transferua nga Barcelona te PSG-ja. Braziliiani ka dëmtuar kavigjirin së fundmi dhe është i detyruar t'i nënshtrohet një operacioni dhe sezoni mbyllet për të. Sulmuesi i talentuar do të jetë një mungesë e madhe edhe për sfidën e rëndësishme ndaj Bayern Munchenit. Në fakt, mungesa e Neymarit ndoshta nuk vëhet re shumë, pasi ish-sulmuesi i Barcelonës ka qëndruar më shumë jashtë fushës, plot 731 ditë, pra dy vjet.

Osimhen: Kvaratskhelia mund ta fitojë 'Topin e Artë'

Victor Osimhen beson se shoku i tij i skuadrës Kricha Kvaratskhelia mund ta fitojë "Topin e Artë". Kvaratskhelia po tregon formë fenomenale këtë sezon, së bashku me Osimhen po udhëheqin ekipin e Napolit drejt suksesit në Serinë A. "Ai është një djalë i mrekullueshëm, e kuptova menjëherë. Të gjithë e duan atë në dhomën e zhveshjes, jo vetëm për atë që bën në fushë, por edhe për atë që bën jashtë saj. Unë besoj se ai mund ta fitojë 'Topin e Artë' në vitet e ardhshme. Shpresoj që ai gjithashtu t'i sjellë shumë suksese Napolit", ka thënë Osimhen. Kvaratskhelia kaloi në Napoli nga Dinamo Batumi në vitin 2022 për shumën e 15 milionë eurove.

Dembele mungon edhe ndaj Realit

Ousmane Dembele nuk do të jetë të dielën në ndeshjen që Barcelona luan kundër Athletic Bilbaos në "San Mames". Mjekët nuk i kanë dhënë leje futbollistit që të kthehet në skuadër. Ata janë kategorikë në këtë pikë, duke marrë parasysh historinë e lëndimeve të francezit. Me Dembelenë duhet të jesh shumë i kujdesshëm. Kjo i është thënë edhe futbollistit edhe Xavi Hernandezit. Të dy menduan se mund të rikthehej në Bilbao, por nuk do të jetë kështu. Ata pëlqejnë ta zgjasin rikuperimin për të mos rrezikuar, ndaj është vendosur që të mos luajnë këtë fundjavë. Futbollisti ka ndjesinë pozitive se mund të kthehet kundër Realit, në ndeshjen e kthimit të Kupës së Mbretit, në "Camp Nou", por edhe në këtë rast mjekët dhe stafi nuk duan të rrezikojnë.



EUROPEAN CENTER
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

INVITATION TO TENDER

European Center for Minority Issues in Kosovo - ECMI Kosovo is implementing the project "Socio-Economic Reintegration for Minority Communities and other Vulnerable Marginalised Groups" with the objective to increase employability of returnees and minorities through harmonization of trainings with labour market needs. The project is funded by the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

ECMI Kosovo invites Bidders to submit, free of charge, and without obligation on part of ECMI Kosovo, a bid on offering **Tools and Equipment (26 packages)** for 140 returnees and minorities.

Interested bidders, can send a request for Terms of Reference via email with reference number ECMI Kosovo/81282318/RTB/6 in the subject line to info@ecmikosova.org.

The responsible ECMI Kosovo officer will provide you with Terms of Reference within two days.

Bidders are not allowed to contact or discuss any aspect of the tender with ECMI Kosovo before closing of the tender as it will lead to automatic disqualification.

Request for Terms of Reference must be sent by e-mail to info@ecmikosova.org before 15 March 2023.

Application deadline is on 24 March, 2023 at 16:00 hrs.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Perla-Oil" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810048654 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Perla-Oil" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810048654 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Perla-Oil" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810048654 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Ex Fis" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Llapushnik komuna e Drenasit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.04.2023 në ora 10:00 në hapësirat e SHMU "XHELADIN GASHI-PLAKU" në Komoran rruga "Shpëtim Robaj" nr. 67 do të organizohet debat publik nga Kompania "Ex Fis" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/7491688086?pwd=U05XRGMzcHpHRjI1OHhxdmNpUWJJCUT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Ex Fis" Sh.p.k Prishtinë për stacionin e karburanteve në Llapushnik komuna e Drenasit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Hotel Golden BNB SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811359183.

- Besnik Gashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Teknike "Nexhmedin Nixha" Elektro Teknik Gjakovë.

- Denis Demjana nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të shm Ekonomike "Kadri Kusari".

- Egon Koci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10.11.12. dhe diplomën e shme "Kadri Kusari" Gjakovë.

- N.T.SH. "Ana" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik. 811526724 nrb. 600307228.

- Enis Xhafa shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani"

- Emir Xhafa shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULË

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues